



Azhurnimi i studimit të fisibilitetit. ESIA dhe  
azhurnimi i projektit të detajuar të ndërtimit të  
rrugës N9 Prishtinë - Pejë (SEETO Rruga 6 B),  
seksioni Kijevë – Klinë deri në Zahaq (30KM)

## Korniza e blerjes së tokës dhe zhvendosjes (Draft)

Projekti për Lehtësimin e Infrastrukturës për Ballkanin  
Perëndimor

IPA 2011-WBIF-IPF3

WB11-KOS-TRA-01



## Evidenca e publikimit dhe rishikimeve

| Rishikimi | Data       | Nga                             | Kontrolluesi       | Miratuesi        | Përshkrimi                                     |
|-----------|------------|---------------------------------|--------------------|------------------|--|
| A         | 25/12/2016 | Ana Petrovska<br>Aferdita Imeri | Ralph<br>Henderson | Gordon<br>Lamond | Korniza për blerjen e tokës dhe<br>zhvendosjen |

Ky dokument është lëshuar për palën që e ka kontraktuar dhe për qëllime specifike që kanë të bëjnë vetëm me projektin e lartpërmendur. Asnjë palë tjetër nuk duhet të mbështetet tek ai dhe as të përdoret për ndonjë qëllim tjetër.

Ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi për pasojat që rrjedhin nëse ndonjë palë tjetër mbështetet tek ky dokument apo nëse ai përdoret për ndonjë qëllim tjetër, apo nëse ka ndonjë gabim apo lëshim që është si pasojë e gabimeve apo lëshimeve në të dhënat që janë dhënë nga palë të tjera

Ky dokument përmban informacion konfidencial dhe që është subjekt i pronësisë intelektuale. Ai nuk duhet t'i tregohet palëve të tjerë pa pajtimin tonë apo të palës që e ka kontraktuar.

## Përmbajtja

|           |   |                                     |
|-----------|---|-------------------------------------|
| 1.        | Hyrja .....   | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |
| 2.        | PROJEKTI .....  | 7                                   |
| 2.1.      | Sipërfaqja e Projektit & Konteksti i shfrytëzimit të tokës .....                | 11                                  |
| 2.2.      | Komunitetet lokale brenda zonës së projektit.....                               | 11                                  |
| 2.3.      | Përmbledhje e ndikimeve të projektit .....                                      | 14                                  |
| 3.        | PËRMBLEDHJE E TOKAVE, NJERËZVE TË PREKUR & PASURIVE .....                       | 16                                  |
| 4.        | KORNIZA LIGJORE DHE E POLITIKAVE PËR BLERJEN E TOKËS DHE ZHVENDOSJEN .....      | 18                                  |
| 4.1.      | Autoriteti i shpronësimit dhe aplikimi i procedurës .....                       | 18                                  |
| 4.1.1.    | Procedura e shpronësimit.....   | 18                                  |
| 4.1.2.    | Vlerësimi i pasurive .....  | 20                                  |
| 4.1.3.    | Konsultimi i personave të prekur nga shpronësimi .....                          | 21                                  |
| 4.2.      | Zbrazëtitë në mes të Legjislacionit të Kosovës dhe Standardeve të BERZH .....   | 23                                  |
| 4.2.1.    | E drejta dhe formaliteti / informaliteti .....                                  | 23                                  |
| 4.2.2.    | Baza dhe studimet .....   | 23                                  |
| 4.2.3.    | Procedurat ankimore .....   | 24                                  |
| 4.2.4.    | Konsultimet Publike .....   | 24                                  |
| 4.2.5.    | Data e skadimit të afatit.....  | 24                                  |
| 4.2.6.    | Kompensimi dhe posedimi.....  | 25                                  |
| 4.2.7.    | Kompensimi .....  | 25                                  |
| 5.        | PRANUESHMËRIA DHE TË DREJTAT .....  | 26                                  |
| 5.1.      | Parimet kryesore të kompensimit, zhvendosja dhe mjetet e restaurimit.....       | 26                                  |
| 5.2.      | Implementimi i regjistrimit, studimi i pasurive dhe studimi socioekonomik ..... | 26                                  |
| 5.3.      | E drejta për kompensim me para të gatshme, zhvendosja dhe asistenca.....        | 27                                  |
| 6.        | ZBULIMI I INFORMACIONIT DHE KONSULTIMI .....                                    | 29                                  |
| 7.        | MEKANIZMAT ANKIMORË.....  | 30                                  |
| 8.        | MONITORIMI, RAPORTIMI DHE BUXHETI .....   | 30                                  |
| 8.1.      | Monitorimi .....  | 30                                  |
| 8.2.      | Raportimi.....  | 32                                  |
| 8.3.      | Shpenzimet e implementimit.....   | 32                                  |
| 8.1.      | Matrica i të drejtës.....   | 33                                  |
| Shtojca A | Matrica e analizës së zbrazëtimeve legjislative.....                            | 38                                  |

## 1. HYRJJE

Ministria e Infrastrukturës (MI) e Kosovës\* është duke planifikuar fillimin e një projekti për ta përmirësuar një pjesë të rrugës nacionale N9 me ndërtimin e një seksioni të një rruge motorike (autostrade) të re Kijevë – Klinë - Zahaq (31km). Projekti është në përputhje me planin gjithëpërfshirës për përmirësimin e rrjetit të rrugëve nacionale, të përkufizuara në Strategjinë Vendore Shumë-Modale (2012-2021) dhe me Planin e Veprimit (2012-2016)<sup>1</sup>. Projekti është pjesë e Rrugës 6 B të SEETO<sup>2</sup> B (Figura 1).



**Figura 1 Lokacioni i projektit për Rrugën 6 B të SEETO**

Banka Evropiane për Investime (BEI) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në përputhje me politikat e tyre<sup>3</sup> dhe Marrëveshjet strategjike me Kosovën\*<sup>4</sup>, janë duke promovuar dhe mbështetur integrimin e transportit regional dhe zhvillimin e lidhjeve strategjike me shtete fqinje. Këtu përfshihet edhe ndërtimi i Rrugës 6 B, e cila shtrihet nga Peja deri në Prishtinë, duke u lidhur me

<sup>1</sup> [http://www.seetoint.org/wp-content/uploads/downloads/2014/01/Kosovo\\_Multimodal-Transport-Strategy-2012-2021.pdf](http://www.seetoint.org/wp-content/uploads/downloads/2014/01/Kosovo_Multimodal-Transport-Strategy-2012-2021.pdf)

<sup>2</sup> Rrjeti Kryesor i Transportit dhe në Organizatën e Transportit të Evropës Jug-Lindore (SEETO).

<sup>3</sup> Politika për Kreditimin e Transportit e EIB (<http://www.eib.org/infocentre/publications/all/eib-transport-lending-policy.htm>) dhe Strategjia e BERZH-it për Kosovë\* (<http://www.ebrd.com/downloads/country/strategy/kosovo-strategy.pdf>)

<sup>4</sup> Marrëveshja Kornizë e EIB për Kosovën\*

(<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20ratification%20of%20Agreement%20between%20Kosova%20and%20European%20Investment%20Bank.pdf>)

Korridorin VIII në ish RF të Maqedonisë në jug dhe me Korridorin X në Serbi përmes Rrugës 7 në veri; po ashtu e lidh Prishtinën, përmes Pejës (një qendër administrative dhe ekonomike e Regjionit përëndimor të Kosovës), në Rrugën 4 në pjesën lindore të Malit të Zi.

Procesi për blerjen e tokës për qëllimet e Projektit gjendet në fazat e hershme. Projekti do të kërkojë blerjen e tokës, por duket se do të ketë raste të kufizuara, ku zhvendosja fizike do të duhet të zhvillohet, sepse do të preken objektet e banimit. Nuk ka prona jo-banesore të cilat do të preken, por kjo do të konfirmohet gjatë planifikimit të mëtejshëm të blerjes së tokës.

Kjo Kornizë për Blerjen e Tokës dhe Zhvendosjen (LARF) është përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës (MI)<sup>5</sup>. Ky dokument është hartuar në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës\* dhe është në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it të vitit 2014 (PMS 2014), e në veçanti me Kërkesat për Performancë 5 (KP5) - Blerjen e tokës, zhvendosjen jo vullnetare dhe zhvendosjen ekonomike. Kjo Korniza për Blerjen e Tokës dhe Zhvendosjen paraqet ndikimet e zhvendosjes të lidhura me Projektin, dhe parimet dhe përgjegjësitë e kompensimit dhe zhvendosjes, për të siguruar që asnjëri nga personat e prekur nga zbatimi i Projektit të mos gjendet në pozitë të pafavorshme në krahasim me kushtet aktuale.

LARF përfshin mekanizmat ankimor për njerëzit e prekur nga blerja e tokës si një mënyrë për të ngritur shqetësimet e tyre dhe kështu ofron një mekanizëm për zgjidhjen e problemeve. Një Plan Veprimi i Hollësishëm për Zhvendosje (RAP) do të hartohet në përputhje me këtë LARF pas përfundimit të planifikimit të detajuar për trasenë e saktë të rrugës. Përderisa LARFpërcakton qasjen e planifikuar të Projektit, proceset, përgjegjësitë dhe të drejtat e kompensimit të tokës blerjen dhe zhvendosjen, RAP do të sigurojë të dhëna të plota të pronësisë aktuale të tokës, natyrën e ndikimeve të zhvendosjes dhe identifikimin e të gjithë personave të prekur nga blerja e tokës. Një studim socio-ekonomik do të kryhet gjatë fazës së ardhshme të zhvillimit të projektit për të kuptuar më mirë shkallën dhe natyrën e zhvendosjes ekonomike dhe fizike dhe këto ndikime tek Personat e prekur nga ky Projekt (PPP). Anketa socio-ekonomike do të përdoret për të informuar RAP.

## 2. PROJEKTI

Rruga aktuale N9 Kijevë - Klinë - Zahaq është një rrugë me 2-korsi vetëm me një trotuar gjatë tërë gjatësisë së saj prej 30km), me një gjerësi në mes 6.5 m dhe 7.0 m.

Projekti (Autostrada e planifikuar) do të jetë një rrugë me dy korsi e projektuar të jetë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe specifikacionet, me një shpejtësi të projektuar prej 100-120 km/orë. Shtrirja rrugore e projektit përshkon një distancë deri në 1.5 km dhe kalon në veri të rrugës ekzistuese N9. Rruga ekzistuese N9 do të përdoret si një rrugë paralele dhe dytësore. Asnjë ndërhyrje në rrugën ekzistuese nuk është planifikuar në kuadër të Projektit.

Autostrada kalon nëpër territorin e komunave Klinë dhe Pejë. Qytetet më të mëdha që gjenden përgjatë Rrugës më të gjerë janë Prishtina dhe Peja.

---

<sup>5</sup> <http://www.mi-ks.net>

Shtrirja rrugore fillon afër Kijevës (38 km në perëndim të Prishtinës) në veri të fshatit Kijevë dhe mbaron në fshatin Zahaq, 7 km në lindje të qytetit të Pejës.

Ekonomia lokale në zonën e projektit është shumë e varur nga bujqësia, me disa aktivitete komerciale dhe të minierave që po ashtu janë duke ndodhur. Është vërejtur një trend i migrimit ekonomik jashtë zonës lokale, drejt qendrave urbane në vend si dhe jashtë vendit. Në përgjithësi, projekti do të përmirësojë lidhjen, do të zvogëlojë numrin e udhëtimeve, dhe do të përmirësojë sigurinë rrugore, ndërsa njëkohësisht do ta përmirësojë qasjen në shërbime komunale për vendbanimet përgjatë rrugës. Disa mundësi të punësimit lokale afat-shkurtër mund të rezultojnë gjatë ndërtimit dhe përmirësimi i lidhjeve potencialisht do të kontribuojë në nxitjen dhe rritje e investimeve në zone, në aspektin afatgjatë.

Rruga kalon nëpër një rrugë regjionale (R 104) dhe disa rrugë lokale. Në dizajnin konceptual të projektit janë planifikuar gjashtë kryqëzime të reja, me shkallë të ndara. Përveç kësaj, disa struktura – një urë (mbi lumin Drini i Bardhë), dy viadukte, nënkalime/mbikalime, kanale me gypa / kuti – janë instaluar përgjatë rrugës.


Një e drejtë-e-kalimit (ose "rezervë e rrugës") prej 20m nga secila anë e projektit do të caktohet me kufizime të vendosura në aktivitete të caktuara brenda një tamponi me gjerësi prej 60 m.

Kryqëzimet me shkallë të ndara do të mundësojnë qarkullim të trafikut në rrugën ekzistuese N9 dhe në rrugën regjionale R-4. Komunitetet lokale kështu do të mund të qasen në rrugët lokale dhe përmes një qasje të veçantë edhe në pronat e tyre dhe në parcelat e tyre të tokës bujqësore. Mbikalimet / nënkalimet do të sigurojnë vazhdimësi të trafikut përgjatë rrugëve lokale.

Dizajni i strukturave të projektit do të jetë i detajuar përgjatë fazave të ardhshme, respektivisht gjatë fazave Preliminare dhe të Dizajnit të Detajuar.

Figurat 2 dhe 3 paraqesin një pasqyrë të trasesë së propozuar 31 km, të Projektit të Autostradës dhe elementeve kryesore të saj.





**Figura 2 Paraqitja e seksionit Km 0+000-Km17+000**



**Figura 3 Paraqitja e seksionit km17+000-km 31+000**

## 2.1. Sipërfaqja e Projektit & Konteksti i shfrytëzimit të tokës

Projekti do të jetë një pjesë e Rrugës në lindje-perëndim, ndërmjet Prishtinës dhe kufirit me Malin e Zi. Prishtina dhe Peja janë qendrat kryesore urbane përgjatë korridorit. Autostrada kalon në territorin e komunave të Klinës dhe Pejës.

Traseja e autostradës shtrihet përmes dy luginave: Fusha e Kosovës, e përbërë nga përroska Drenica, (degë e lumit Sitnica) dhe Lugina e Dukagjini, e formuar nga lumenjtë Drini i Bardhë dhe Bistrica e Pejës. Pjesa e parë e shtrirjes rrugore shtrihet mbi një pllajë të rrafshët; terreni pastaj gradualisht zbret drejt shtratit të lumit Drini i Bardhë dhe pastaj ka një ngritje të lehtë në pikat më të larta drejt Pejës. Dallimi në mes të pikës më të ultë (370 m) dhe më të lartë (615m) të korridorit është 245m. Lloji tipik i tokës në këtë pjesë është toka bujqësore dhe kullotat me disa livadhet dhe pjesë të pyjeve.

Përdorimi i tokës në terren të rrafshët dhe të hapur kryesisht përqendrohet rreth parcelave bujqësore dhe pemishte. Kullotat dhe pyjet e shkatërruara janë veti dominuese e terreneve të larta (bregore) Sipas informatave që i kemi në dispozicion, pjesa dërrmuese e tokës është në pronësi private.

## 2.2. Komunitetet Lokale brenda Zonës së Projektit

13 vendbanime gjenden përgjatë projektit të autostradës: Dollc, Zajm dhe Drenoc (të ndara) dhe Drsnik, Jabllanicë, Kliçinë, Leshan, Lugagji, Gllaviqicë, Ramun dhe Zahaq; Rruga po ashtu kalon nëpër pjesën veriore të fshatrave Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm, duke e lënë një numër të pronave të shkëputura nga pjesa tjetër e vendbanimeve (Tabela 1).

**Tabela 1 Lokacioni, Pozita dhe Distanca e vendbanimit nga traseja e autostradës**

| Vendbanimet       | Pozita në Km e trasesë (RHS/LHS) | Dendësia e zonës rezidenciale   | Distanca deri tek traseja |
|-------------------|----------------------------------|---|---------------------------|
| Drsnik            | 11+300 (0,6km LHS/RHS)           | Zonë rezidenciale me dendësi të ultë me prona të ndara; disa prona rezidenciale janë të pranishme brenda të drejtës së kalimit prej 20 metra  | 3-5                       |
| Dollc             | 12+900 (1,5km LHS)               |   | 70                        |
| Zajm              | 15+000 (RHS/LHS)                 | Zonë rezidenciale me dendësi të mesme me prona të ndara; disa prona rezidenciale janë të pranishme brenda të drejtës së kalimit prej 20 metra | 70                        |
| Drenoc            | 19+000 (RHS/LHS)                 |   | 5-15                      |
| Pjetërq i Poshtëm | 21+300 (0,5km LHS/RHS)           |   | 60                        |
| Pjetërq i Epërm   | 21+300 (1,6km LHS)               | Zonë rezidenciale me dendësi të mesme me prona të ndara   | 10                        |
| Jabllanicë        | 23+100 (1,1km LHS)               | Zonë rezidenciale me dendësi të ultë me prona të ndara  | 100-150                   |

| Vendbanimet | Pozita në Km e trasesë (RHS/LHS) | Dendësia e zonës rezidenciale   | Distanca deri tek traseja |
|-------------|----------------------------------|---|---------------------------|
| Kliçinë     | 24+400 (0,9km LHS)               | Zonë rezidenciale me dendësi të mesme me prona të ndara   | 80                        |
| Leshan      | 25+400 (0,8km LHS)               |   | 80                        |
| Lugagji     | 26+350 (0,8km LHS)               | Zonë rezidenciale me dendësi të ultë me prona të ndara  | 80                        |
| Gllaviqicë  | 27+700 (0,85km LHS)              |   | 100-150                   |
| Ramun       | 29+200 (1,1km LHS)               |   | 80                        |
| Zahaq       | 30+850 (RHS/LHS)                 | Zonë rezidenciale me dendësi të mesme me objekte banesore të ndara.<br>Po ashtu ekzistojnë edhe disa prona komerciale . |                           |

6 vendbanime i përkasin komunës së Klinës dhe 7 vendbanime gjenden në komunën e Pejës. Gjithsej 8,743 banorë banojnë në vendbanimet e prekura. Numri i njerëzve të prekur drejtpërdrejt nga Projekti nuk është i njohur në këtë fazë të hershme të dizajnit.

Burimi i të ardhurave për familjet që gjenden në zonat e prekura kryesisht buron nga puna private, prodhimi bujqësor familjar dhe puna sezonale, në një masë më të vogël. Familjet nuk shfrytëzojnë eksplotimin komercial të drurit, megjithatë ai e ul koston totale të jetesës, duke siguruar qasje të lirë si material për ngrohje. Papunësia në komunat e prekura arrin në 47%. Nga numri i përgjithshëm i femrave të afta për punë, 14.23% janë të punësuar në mënyrë aktive, ndërsa tek meshkujt përqindja është 38.85% nga numri i përgjithshëm. Shkalla e papunësisë në këtë zonë në shkallë të konsiderueshme e tejkalon mesataren kombëtare e cila qëndron në 24.7%. Në periudhën e fundit 5-vjeçare, migrimi i banorëve të rinj në fshatrat që gjenden përgjatë seksioni të trasesë në afërsi të Prishtinës ka qenë veçanërisht akut. Fshatrat që ndodhen në afërsi të Pejës nuk kanë pësuar një trend të ngjashëm.

Sipas informacionit në dispozicion, nuk ekziston asnjë objekt komercial dhe industrial brenda korridorit të ngushtë të Projektit. Prania / mungesa e bizneseve aktive në trasenë e Projektit do të miratohet në fazën paraprake të Dizajnit, për Rrugën e rafinuar.

Vendbanimet e përkshuara nga traseja e autostradës janë të paraqitura në figurën e mëposhtme.




Figura 4: Vendbanimet e ndikuara nga Projekti

### 2.3. Përmbledhje e ndikimeve të Projektit

#### Kërkesat e Projektit në lidhje me tokën

Blerja e përhershme e tokës: blerjen e përhershme e tokës do të jetë e nevojshme për ndërtimin e autostradës, duke përfshirë lidhjet dhe strukturat e të tjera të lidhura (të cilat janë në kuadër të fushëveprimit të Projektit), etj. Sipërfaqet e tokës për blerje të përhershme mbetet të konfirmohen në studimet e ardhshme. Autostrada do të përbëhet nga katër shirita të trafikut (15.00m '), shiriti për ndalje (5.00m'), shiriti emergjent (1.40m '), barrierat mes dy shiritave (1.75'), Krahu (2.00m ') dhe ndarja mes dy korsive (4.00m '), duke e bërë një total të 27.40m të gjerësisë së përafërt të trotuarit.

Marrja e tokës do të jetë e nevojshme për ndërtimin e margjinave dhe kryerjen e punimeve të nevojshme të dheut. Një zonë për asgjësimin e dheut (d.m.th materialit të tepërt të gërmuar) duhet të identifikohen përgjatë rrugës.

Në pajtim me **Ligjin për rrugët** një 20 m drejta-e-kalimit (rezervë rrugore) do të lihet në çdo anë të autostradës; brenda kësaj tampon zone ndërtimi i çfarëdo objekti banesor apo jo-rezidenciale do të ndalohet gjatë tërë jetëgjatësisë së punimeve të autostradës. Pronarët e tokave do të duhet të marrin leje nga MI për ngritjen e ndonjë strukture të re, si dhe për strukturat ekzistuese të ngritura, nëse ndodhen brenda kufijve të rezervës rrugore. Strukturat ekzistuese brenda rezervës rrugore të zonave të sigurisë mundësisht do të pastrohen, nëse vërtetohet që nuk mund të ndërmerren kurrfarë masash për zvogëlimin e zhurmës për të mbrojtur strukturat e gjetura në atij rripi rrugor.

*Marrja e përkohshme e tokës:* Projekti gjithashtu do t'i duhet të marrë disa toka të përkohshme për rrugët transportuese/ndërtimore, zona e punishteve ndërtimore dhe kampeve, magazinimin e përkohshëm të materialeve të gërmuara / dheut, pemët e prera etj. Megjithatë, informacioni dhe të dhënat në lidhje me marrjen e përkohshme të tokës nuk janë të njohura në kohën e hartimit të e zhvillimit të LARF dhe do të përfshihen në LARF dhe RAP e përditësuar. Marrëveshjet për marrjen e tokës së përkohshme shtesë të kërkuar nga Kontraktuesi, për aq sa është e mundur, do të miratohen përmes negociatave dhe marrëveshjes miqësore nga pronarët e tokës.

#### Përmbledhje e ndikimeve të zhvendosjes ekonomike dhe fizike

Gjatë planifikimit të rrugës dhe projektimit të projektit, kërkesat e blerjes toka ishin një nga çështjet kryesore. Zhvendosja fizike e amvisërive përgjithësisht shmangej me një rrezik të caktuar të zhvendosjes fizike të mbetur. Shmangia e zhvendosjes fizike duhet të merret si një premisë në fazat e ardhshme të projektimit, në mënyrë që të parandalohet zhvendosja e objekteve ekzistuese që gjenden në kuadër të tampon zonës prej 20-metra në masën më të madhe të mundshme.

Kërkesat e projektit për marrjen e tokës ndikojnë tek parcelat e tokës dhe pasurive që janë në pronësi private. Sipas hetimeve paraprake një përmbledhje e ndikimeve të mundshme nga zhvendosjen ekonomike dhe fizike është paraqitur më poshtë. Lista e saktë e ndikimeve dhe planifikimi i detajuar i të drejtave për kompensimin dhe asistencën për këto ndikime do të ofrojë informacione nga rezultatet e anketës/sondazheve socio-ekonomike dhe të cilat do të jenë të përfshira në RAP të Projektit:

**Tabela 2 Përmbledhje e ndikimeve të zhvendosjes fizike dhe ekonomike Tabela 3**

| Faza/ Lloji i humbjes                             | Përmbledhje e humbjeve/ndikimeve  |
|---|---|
| <b>PARA-NDERTIMI – Para ndërtimit<sup>6</sup></b> |   |
| Marrja e përhershme e tokës                       | <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Humbja e tokës (kryesisht bujqësore, pyjet dhe / ose kullotat - mund të jetë një sasi e vogël e vreshtave, pemishteve dhe tokës ndërtimore):</b> Projekti do të rezultojë në humbjen e tokës, kryesisht bujqësore (të përdorur dhe të braktisur) dhe kullotave / zona të gjelbëruara dhe disa zona pyjore dhe disa copa të të lashtave në shkallë të vogël (p.sh. duhani etj) dhe vreshtat dhe pemishtet gjithashtu mund të preken. Potenciali për rastet e tokës ndërtimore është i ulët, por mund të jetë i pranishëm. Toka është kryesisht në pronësi private. Marrja e tokave përfshin një rrip toke përgjatë autostradës.</li> <li><b>Humbja e objekteve banesore (zhvendosjes fizike):</b> Rreziku i zhvendosjes fizike të pronave të përdorura për qëllime banimi është shmangur / minimizuar në masë të madhe nga shtrirja rrugore. Procesi i vazhdueshëm i tokës ka nevojë që të konfirmohet numrin i objekteve të banimit që janë të prekura si dhe çdo zhvendosje fizike të njerëzve. Sondazhi i propozuar socio-ekonomik i kombinuar për toka dhe inventar të aseteve të ndërmarrë për procesin e blerjes së tokës duhet të mundësojë ndonjë zhvendosje fizike që do të konfirmohet.</li> <li><b>Humbja e burimeve të të ardhurave dhe / ose mjeteve të jetesës të lidhur me ndonjë nga humbjet e mësipërme dhe në veçanti mjetet 'bujqësore' të jetesës:</b> Disa prej familjeve në fshatrat lokale janë të varur nga aktivitetet e jetesës nga toka që mund të preken nga humbja e tokës apo qasja në tokë që e shfrytëzojnë (p.sh. përdorimi zakonor potencialisht pa të drejtë ligjore – gjë që duhet të konfirmohet gjatë procesit të blerjes së tokës në të ardhmen).</li> <li><b>Toka bonjake:</b> (p.sh. një copë toke e prekur e cila mbetet pas shpronësimit dhe për të cilat pronari nuk ka më interes ekonomik për ta shfrytëzuar dhe / ose e cila është një parcelë ekonomikisht e paqëndrueshme)</li> </ul> |
| <b>GJATË NDËRTIMIT:</b>                           |   |
| Efektet e përkohshme:                             | <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Humbja e përkohshme e tokës (kryesisht toka bujqësore, pyjet dhe / ose kullotat - mund të jenë kopshtet e vogla dhe tokat ndërtimore) - e nevojshme gjatë periudhës së ndërtimit.</b></li> <li><b>Humbja / dëmtimi i kulturave një vjeçare / shumëvjeçare dhe drunjtë, duke përfshirë drunjtë brenda kopshtit.</b></li> <li><b>Dëmtimi / ndërprerja e përkohshme e infrastrukturës së caktuar bujqësore (p.sh ujti)</b></li> <li><b>Humbja e përkohshme e dhe / ose qasje më e vështirë në tokën bujqësore ose burimeve të tjera të jetesës që kanë lidhje me shfrytëzimin e tokës dhe pengimet ndaj automjeteve bujqësore / blegtorale etj gjatë përdorimit të rrugës N9 ekzistuese dhe rrugëve të tjera ekzistuese për tek toka etj .:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Punimet e autostradës së re gjatë ndërtimit do të rezultojnë në efekte qasjes së</li> </ul> </li> </ul>   |

<sup>6</sup> Pasi që pagesa e kompensimit të humbjeve dhe zhvendosjes duhet të ndodhë para se qasja në tokë të arrijë efektin e përhershme të humbjes së tokës dhe aseteve në përgjithësi ndodh në fazën e Para-ndërtimore.

| Faza/<br>Lloji i<br>humbjes    | Përmbledhje e humbjeve/ndikimeve   |
|--------------------------------|--|
|                                | <p>lokalizuara dhe mund, nëse nuk menaxhohen si duhet, të rezultojnë në veçimin e komuniteteve nga zonat e tokave të tyre prodhuese. Ruajtja e qasjes në tokën bujqësore dhe automjetet bujqësore dhe lëvizjet e kafshëve etj për fshatrat lokale konsiderohet e domosdoshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Kontraktuesi do të jetë e nevojshme që të ketë një plan të mirë Menaxhimi të Trafikut të mbështetur me angazhim efektiv të komunitetit lokal dhe sekuenca të kujdeshme të punimeve për të siguruar që qoftë rruga ekzistuese apo rrugët e reja lokale paralele të jenë në dispozicion për të siguruar që qasja të ruhet në çdo kohë. Me supozimin që se këto masa janë zbatuar nuk parashihet të ketë efekte të tjera të rëndësishme gjatë ndërtimit megjithëse mund të ketë një rritje të lehtë në gjatësinë e udhëtimit për disa nga komunitete lokale.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Humbja e burimeve të të ardhurave dhe / ose mjeteve të jetesës të lidhura me ndonjë nga humbjet e mësipërme dhe në veçanti jetesa 'bujqësore' dhe pengesa ndaj bizneseve</b></li> </ul>  |
| <b>GJATË OPERIMIT:</b>         |  |
| Efektet e qasjes së përhershme | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Humbja dhe / ose qasje më të vështirë në tokë, objekte komerciale dhe / ose rrjetin rrugor:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ndryshimet e përhershme në aranzhimet e qasjes lokale të lidhur me zbatimin e autostradës mund të rrisin kohën e udhëtimit etj Në hartimin e projektit ekzistojnë dispozita të mjaftueshme për të siguruar që qasja tek komunitetet lokale të ruhet me anë të nënkalimeve, mbikalimeve. Pasi që automjetet bujqësore nuk do të jenë në gjendje ta përdorin autostradën, kjo gjë mbetet thelbësore.</li> <li>○ Potencialisht një numër shumë i vogël i familjeve mund të zotërojë ose ta përdor tokën për veprimtari bujqësore të jetesës në anën e kundërt të autostradës ku ata jetojnë. Ml gjatë studimit socio-ekonomike, në qoftë se ata identifikojnë këtë çështje, do të diskutojë me palët e prekura nga rritja e kohës së udhëtimit për në tokën e tyre dhe për opsionet e asistencës që do të marrin parasysh ndjeshmërinë dhe varësinë e palëve të prekura në aktivitetet e bazuara në tokë. Kjo është e mbuluar në matricën e të drejtave (shih seksionin 8.1 më poshtë).</li> </ul> </li> </ul> |

### 3. PËRMBLEDHJE E TOKËS, NJERËZVE & PASURIVE TË PREKURA

Informacioni mbi sipërfaqen e tokës së prekura, parcelat, pronarët dhe strukturat e paraqitura në këtë LARF është i bazuar në të dhënat në dispozicion në kohën e përgatitjes së dokumentit. Këto shifra nuk përmbajnë marrje të përkohshme të tokës të nevojshme për Punët dhe / ose Kontraktuesin - qasje e përkohshme e tokës do të dakordohet përmes negociatave.



**Tabela 4 Përmbledhje e llojit të tokës së prekur**

| Llojet e e tokave sipas përdorimit           | Sipërfaqja (ha) |
|--|-----------------|
| Toka pyjore                                  | 38.28           |
| Tokat e gjelbra semi naturale                | 3.70            |
| Toka bujqësore                               | 75.16           |
| Tokat në pronësi të amvisërive dhe bizneseve | 6.34            |

Disa ndërtesa banimi janë identifikuar deri më tani si të prekura dhe që kërkojnë rrënim. Gjatë fazave vijuese të projektimit do të bëhen përpjekje të arsyeshme për të shmangur çdo rrënim shkaku i punimit të Rrugës. Planifikimet e blerjes së tokës në të ardhmen do ta konfirmojnë numrin e pronave të prekura (të lejuara dhe atyre pa leje të vlefshme) përgjatë autostradës.

Mund të ketë tokë që është duke u përdorur (p.sh për qëllime bujqësore), në zonë në mënyrë joformale (p.sh. përdoruesit mund të mos kenë asnjë të drejtë ligjore), dhe në baza të zakoneve. Kjo do të shqyrtohet gjatë studimit socio-ekonomike dhe inventarit të tokës dhe asetëve. Është e mundur që një numër i objekteve që gjenden në vendbanime joformale të cilat ndodhen në afërsi të Pejës nuk kanë leje të vlefshme.

Duhet theksuar që informacioni kadastral mund të ketë boshllëqe në informacion dhe do të duhet: i) të verifikohen në terren (gjatë studimit socio-ekonomike dhe gjatë inventarizimit të tokës dhe të pasurisë); ii) me anë të vlerësimit të pronave; dhe iii) procesi i konsultimit me pronarët e prekur të tokës dhe përdoruesit. Disa nga mangësitë e mundshme mund të përfshijnë si në vijim:

- Përdoruesit e paregjistruar të tokës dhe pronave;
- Pronarët e vdekur, me trashëgimtarët ligjorë të cilët janë të paregjistruar dhe / ose nuk e kanë përfunduar procesin e trashëgimisë;
- Ndryshimet e paregjistruara në pronësinë e pronës;
- E drejta e përdorimit e paregjistruar (p.sh. toka e dhënë me qira - mund të jetë në baza të zakonshme)
- Objektet e paregjistruara banesore dhe jo-banesore;
- Objektet shpesh të paregjistruar që e tejkalojnë madhësinë e regjistruar të objekteve ekzistuese;
- Objektet e paregjistruara (p.sh. objektet pa leje).

## 4. KORNIZA LIGJORE DHE E POLITIKAVE PËR BLERJEN E TOKËS DHE ZHVENDOSJEN

Procesi i shpronësimit të pronës së paluajtshme në Kosovë rregullohet me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03 / L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, përkatësisht Ligjin nr. 03 / L-205 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2001. Ligji garanton që shpronësimi i pronës private ndodh vetëm për interes publik dhe përmes një procesi të drejtë të kompensimit.

### 4.1. Autoriteti i shpronësimit dhe aplikuesi i procedurës

Nëse të gjitha kushtet e zbatueshme të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 03 / L-205, Ligji për ekspropriim, janë të pranishme, Organi përkatës Shpronësues (mund të vazhdojë kryerjen e shpronësimit në përputhje me procedurat e aplikueshme dhe kushtet e përcaktuara me ligj).

Procedura e shpronësimit mund të iniciohet nga Organi përgjegjës shpronësues (siç është specifikuar në fjalorthin e Departamentit për Shpronësim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), siç është përcaktuar me nenin 4 të këtij ligji, me vetiniciativë ose sipas një kërkesë të paraqitur Organit Shpronësues.

Aplikacionet mund të dorëzohen nga një Autoritet Publik (agjenci qeveritare) ose një ndërmarrje në pronësi publike. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, një kërkesë mund të paraqitet nga:

- Një partneritet publiko-privat;
- Një palë e një Kontrate të Infrastruktura të shpërblyer nga një Organ Tenderimi; ose
- Çfarëdo trashëgimtar ligjor, pasardhës, pranues ose marrës i një partneriteti ose palë.

Nëse organi shpronësues është duke vepruar me vetiniciativë, do të duhet që një ose më shumë anëtarë të tij apo zyrtarë ta përgatisin dhe dorëzojnë aplikacionin.

**Autoriteti i Shpronësimit është Qeveria e Kosovës, konkretisht Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Ministria e Infrastrukturës është aplikuesi. Ajo do të aplikojë për Procedurën e Shpronësimit nën kontrollin e Autoritetit Publik**

#### 4.1.1. Procedura e shpronësimit

Sipas nenit 8 të ligjit për shpronësim kërkesa për shpronësimin përmban informacionin vijues:

- Emrin dhe adresën e Organit Shpronësues dhe nëse Organi Shpronësues (Departamenti i Shpronësimit në PMS) nuk është duke vepruar me vetiniciativë, emrin dhe adresën e parashtruesit të kërkesës (këtu, parashtruesi do të jetë Ministria e Infrastrukturës - Agjencia implementuese).
- Emrin dhe adresën e secilit person i cili është, ose që pretendon të jetë, një pronar ose zotërues i Interesit në lidhje me çdo parcelë të pronës së paluajtshme, në rast se ky informacion mund të konstatohet lehtësisht nga të dhënat kadastrale në dispozicion dhe të dhënat tjera zyrtare mbi pronën e paluajtshme në Kosovë, duke përfshirë të dhënat e Agjencisë Kosovare të pronës dhe të dhënat e fundit të tatimit në pronë;
- Vendi dhe numri i çdo parcelë të pronës së paluajtshme, dhe - në qoftë se më pak se e gjithë zona e parcelës duhet të shpronësohet dhe / ose nëse më pak se të gjitha të drejtat në lidhje me çdo parcelë të tillë do të shpronësohet – nevojitet një përshkrim specifik i pjesës dhe / ose të të drejtave të cilat janë objekt i kërkesës;
- Për çdo parcelë të tillë, nevojitet një përshkrim për çdo dhe të gjitha të drejtat (të konfirmuara ose të pretenduara) në lidhje me parcelën e tillë që parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që të shpronësohet.
- Një përshkrim i detajuar i qëllimit publik për të cilin shpronësimi është kërkuar;
- Çdo dokument i rëndësishëm që e provojnë ligjshmërinë e qëllimit publik dhe / ose domosdoshmërinë e aplikuar për shpronësimin (ose, nëse këto dokumente janë në dispozicion në formë elektronike, një tregues i qartë se ku mund të sigurohet një dokument i tillë);
- Informacioni mbi të, nëse, dhe në çfarë mase, shpronësimi i kërkuar përfshin pjesët ndihmëse dhe / ose frytet e pasurisë së paluajtshme; dhe
- Informacione të hollësishme, për atë se sa kjo është e vërtetueshme nga të dhënat e përcaktuara në pikën 1.2 të këtij paragrafi, lidhur me çfarëdo kufizimi ose kontesti mbi pronësinë ose të drejtat ose interesat e mbajtura të tjera ose pohohet që do të mbahet nga personat e identifikuar në pikën 1.2 të këtij paragrafi .

Autoriteti i shpronësimit merr vendimin përfundimtar për miratim apo refuzim, në tërësi ose pjesërisht të kërkesës për shpronësim. Për sa kohë që një ankesë nuk zgjidhet në gjykatën kompetente, Autoriteti Shpronësimi nuk e miraton Vendimin Përfundimtar për çdo pronë në fjalë apo të drejtë.

Autoriteti shpronësues duhet të kryejë vlerësimin e pasurive të patundshme (shih § "vlerësimi i mjeteve" më poshtë). Ligji parashikon që shuma e kompensimit për shpronësim të përcaktuar në vendimin përfundimtar të jetë paguar në tërësi brenda dy (2) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

Një procedurë e Shpronësimit në tërësi ose pjesa përkatëse e saj, do të përmbillet ose ndalohet kur:

- Transferimi i pronësisë nuk mund të kalojë pa përfundimin e procedurës dhe pagesën e kompensimit. E drejta e pronësisë mbi pronën e shpronësuar duhet të regjistrohet në mënyrë të ligjshme në emër të Komunës (nëse Shpronësimi është kryer nga Organi Shpronësues i një komune të tillë) ose Republikës së Kosovës (në rast se qeveria është Organi Shpronësues) pas kryerjes së procedurës dhe pagesës së kompensimit të kërkuar nga ligji;
- Nëse Organi Shpronësues nxjerr vendim për refuzimin, në tërësi ose pjesërisht, të kërkesës për shpronësim:
  - pas skadimit të periudhës kohore gjatë së cilës parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e vendimit, nëse parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ankesë brenda afatit të paraparë, ose
  - nëse parashtruesi i kërkesës ka paraqitur brenda afatit të paraparë, datën në të cilën një vendim i formës së prerë ka qenë i lëshuar nga gjykata, ose nëse është e aplikueshme, nga një gjykatë apeli;
- Para miratimit të një vendimi për shpronësim, parashtruesi e tërheq kërkesën e tij, në tërësi ose pjesërisht; ose
- Një vendim i formës së prerë të gjykatës kompetente kërkon përfundimin ose mbarimin e tillë.

Nga dita kur shpronësimi hyn në fuqi: të gjithë pronësitë para-ekzistuese e dhe të drejtat poseduese, interesat e sigurisë, servitutet, të drejtat e ndërtimit, të drejtat e parablerjes dhe të drejta të tjera në ose në pronën e shpronësuar duhet të ndërpriten përmes vendimit për shpronësim.

#### 4.1.2. Vlerësimi i pasurive

Vlerësimi i pasurive të patundshme rregullohet me anë të ligjit nr. 03 / L-205 dhe Udhëzimit Administrativ (nr. 13 / 2011) për miratimin e metodave teknike të vlerësimit dhe kriteret e përdorur për të llogaritur shumën e kompensimit për pronën e shpronësuar të paluajtshme dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin. Vlerësimi i vlerës së pasurive të patundshme është i bazuar në tri metodat e përcaktuara në udhëzimin administrativ lartpërmendur.

Një nga metodat e mëposhtme ose metodat e kombinuara të vlerësimit të pronës mund të zgjidhen gjatë vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Janë të njohura tri metoda të ndryshme të vlerësimit sipas udhëzimit administrativ në fjalë, të tilla si:

- Metoda e shitjes krahasuese;
- Metoda e kostos, dhe
- Metoda e të ardhurave.

Vlerësimi i pronës bëhet nga Zyra e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme në Departamentin e Tatimit në Pronë, ushtrimin e përgjegjësive të tij sipas ligjit nr. 03 / L-139 për "Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme". Zyra e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme e vlerëson pronën dhe dëmet në lidhje me shpronësimin, e cila kërkon informacione apo të dhëna që kërkohet në institucione të tilla si Zyrat Kadastrale Komunale, Gjykatat përkatëse, Agjensioni Kosovar i Pronës (AKP-së), Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Departamenti i Tatimit në Pronë (PTD) në kuadër të Ministrisë së Financave (MF), dhe në çdo institucion tjetër shtetëror që administron pronën ose mund të japin informacion në lidhje me të. Zyrtarë të Zyrës së Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme duhet të marrin informacione shitesë nga agjencitë e pasurive të patundshme, juristët dhe kompanitë e ndërtimit.

Çmimi i pasurive të patundshme, që janë tokë bujqësore, e merr parasysh cilësinë e tokës, afërsinë me vendbanimin, qasjen në infrastrukturë, madhësinë dhe formën e parcelës, sistemin e ujitjes apo potencialin e ujitjes, si dhe kushtet e tjera mjedisore që lidhen me lartësinë dhe pjerrtësinë e terrenit. Vlera e tokës pyjore dhe pyjeve, përcaktohet në bazë të cilësisë së tokës, vlerës mjedisore të tokës, vendndodhjes gjeografike, numrit të drunjve (biomasës), vlerës së lëndës drunore dhe pemëve tjera, nivelit të investimeve dhe qasjes në infrastrukturë, kushteve të transportit, dhe kushteve mjedisore. Në anën tjetër, sa i përket vlerësimit të vlerës së ndërtesave, ligji dhe dispozitat e tij përcaktojnë të merren parasysh disa kritere si: lloji i ndërtesës, materiali ndërtimor, zona në m<sup>2</sup> për objektin banesor dhe jobanesor, viti i ndërtimit, qasja në rrugë, qasja në shërbimet publike, sistemi i ngrohjes, gjendja e objektit, Marrja me qira dhe kushtet e qirasë, kostoja e operimit dhe mirëmbajtjes, etj

#### **4.1.3. Konsultimi me personat e ndikuar nga shpronësimi**

Ligji i Kosovës nr. 03 / L-139 për shpronësimin e përcakton pronën e paluajtshme, sidomos në nenin 9, kushtet në të cilat do të kryhet dëgjimi publik dhe konsultimet publike. Hapat kryesorë të këtyre këshillimeve ligjore janë të përmbledhura më poshtë.

- Brenda dhjetë (10) Ditëve të punës pas miratimit të kërkesës për shpronësim duhet të nxirret një vendim për pranimin e kërkesës për shqyrtim të mëtejshëm. Organi Shpronësues do ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë. Brenda të njëjtës periudhë Autoriteti i Shpronësimi i njofton personat e prekur nga vendimi dhe e thërret dëgjimin publik me personat e prekur në çdo komunë ku shpronësimi është i nevojshëm.
- Duke filluar nga data e kësaj kërkesë për publikim, nevojitet një periudhë prej tridhjetë (30) ditëve kalendrike gjatë të cilit çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e veta me shkrim Organit Shpronësues në lidhje me Shpronësimin e kërkuar.
- Menjëherë pas përfundimit të periudhës për paraqitjen e komenteve të specifikuar më sipër, do të ketë një periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendrike gjatë të cilit Organi Shpronësues do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e kërkuar në çdo komunë ku prona në fjalë

është e vendosur. Çdo person i cili është një zyrtar publik i Komunës, ku një seancë e tillë është duke u mbajtur, ose Pronar ose Zotërues i Interesit në lidhje me pronën e cila gjendet brenda Komunës në të cilën mbahet dëgjimi, ose avokat ose përfaqësues i ndonjë personi të tillë, do të ketë të drejtë të merr pjesë në dëgjimin publik. Çdo personi të tillë do t'i jepet një mundësi e arsyeshme që gojarisht t'i shpreh mendimet e veta në lidhje me shpronësimin.

Kërkesat e BERZH-it që kanë të bëjnë me blerjen e tokës dhe zhvendosjes, dhe që janë të rëndësishme për këtë projekt mund të përmbliken si më poshtë:

- të shmanget ose të paktën të minimizohet zhvendosja e detyruar e përhershme ose e përkohshme fizike ose ekonomike e projektit, kur është e mundur, duke eksploruar planet alternative të projektit; kur zhvendosja është e pashmangshme, duhet të bëhet plan i veprimit i përshtatshëm, për kompensim, zhvendosje dhe restaurim të jetesës;
- të zbuten ndikimet negative sociale dhe ekonomike nga blerjen e tokës ose kufizimet në përdorimin e qasjes në tokë, pasurive fizike ose burimeve natyrore nga personat e prekur:
  - të ofrohet kompensim për humbjen e pasurive në koston e zëvendësimit, para marrjes në posedim të pasurive të fituara; dhe
  - të sigurohet që do të planifikohen dhe zbatohen aktivitetet e kompensimit, zhvendosjes dhe restaurimit jetesës përmes përhapjes së informacionit, konsultimit, si dhe pjesëmarrjes e informuar të atyre që preken. Sa herë që mundet institucionet sociale dhe kulturore ekzistuese të njerëzve të prekur duhet të përdoren në masën më të madhe të mundshme;
- të përmirësohet ose, të paktën, të rikthehet jetesa, kapacitetet e fitimit të të ardhurave dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur, përfshirë edhe ata që nuk kanë të drejta që u njihen me ligj apo pretendime për tokën (e pranishme në zonën e prekur të projektit në kohën skadimit të afatit), në gjendjen e para-projektit dhe mbështetjen e tyre gjatë periudhës së tranzicionit;
- të nxjerr dispozita të veçanta për të ndihmuar individët në nevojë ose grupe në nevojë (të pranishëm në zonën e prekur të projektit në kohën e datës së skadimit) ose që mund të preket më shumë negativisht nga zhvendosja se të tjerët dhe që mund të jenë të kufizuar në aftësinë e tyre për të kërkuar ose për të përfituar ndihmën e jetesës dhe përfitimet tjera të ndërlidhura me këtë çështje;
- të krijojë një mekanizëm të ankesave për t'i pranuar dhe adresuar në kohën e duhur shqetësimet specifike në lidhje me kompensimin dhe zhvendosjen që janë ngritur nga personat e zhvendosur, duke përfshirë një mekanizëm mbrojtës të projektuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të paanshme.

Kjo listë është vetëm një përmbledhje e kushteve kryesore të BERZH PR 5 dhe është kualifikuar duke iu referuar tekstit të plotë të politikës në fuqi <sup>7</sup>

## **4.2. Zbrazëtitë ndërmjet Legjislacionit të Kosovës dhe Standardeve të BERZH-it**

### **4.2.1. E drejta dhe formaliteti/informaliteti**

Në kornizën legjislative të Kosovës, shpronësimi është i aplikueshëm vetëm për pronën dhe ndërtimin e strukturave të paluajtshme në pronën e paluajtshme private dhe jo për pronën dhe objektet e ndërtuara pa leje apo cenim të pronës publike. Sipas legjislacionit të Kosovës procesi i shpronësimit aplikohet vetëm për objektet që legalizohen ose kanë qenë në gjendje të legalizohen sipas ligjeve në fuqi në Kosovë në datën e nxjerrjes së vendimit përfundimtar për shpronësim. Ligji parasheh që shpenzimet e procedurës së vlerësimit duhet të paguhen nga organi shpronësues. Nëse një objekt ose strukturë tjetër e objektit është e ndërtuar në mënyrë të paligjshme dhe mund të legalizohet, por nuk është legalizuar, atëherë kompensimi për humbjen e këtij objekti apo strukturës së ndërtesës do të kufizohet vetëm me shpenzimet e dokumentuara për ndërtimin e saj. Ligji gjithashtu parashikon kompensim në rast të ndërprerjes së kontratës së qirasë dhe strehim të përkohshëm.

Kjo nuk është në përputhje me parimet e vlerës së sugjeruar të shpronësimit në standardet e performancës për blerjen e tokës, zhvendosjen jo-vullnetare dhe zhvendosjen ekonomike të përmendur më tej si standardi i Performances 5. Standardet e Performancës së BERZH-it përfshijnë parimet që mungesa e dokumentacionit të pronësisë nuk do ta ndalojë nga e drejta për ndihmë ndonjë konkurrent ose pretendues mbi të drejtën pronësore, ndërsa në bazë të legjislacionit të Kosovës, mospërputhjet me këtë parim janë të theksuara. Praktika është e tillë që pasuritë e paluajtshme duhet të paguhen pavarësisht nga vendndodhja e tyre, në tokë private apo publike.

### **4.2.2. Baza dhe studimet**

Legjislacioni kosovar kërkon inventarizimin e pasurive të humbura. Jo me doemos kërkohen studime socio-ekonomike për identifikimin e të gjitha ndikimeve, duke përfshirë edhe jetesën e humbur.

Politika e BERZH-it kërkon një vlerësim socio-ekonomik të ndikimeve nga marrja e tokës. Studimi socio-ekonomik do të ndihmojë për të kuptuar natyrën e ndikimeve, duke bërë të mundur zhvillimin e masave të përshtatshme të kompensimit, duke përfshirë çdo ndihmë të posaçme që kërkohet. Studimi bazë do të

---

<sup>7</sup><http://www.ebrd.com/who-we-are/our-values/environmental-and-social-policy/performance-requirements.html%20>

ofrojë informacion për monitorim të mëvonshëm të marrjes së tokës dhe zhvendosjes për të siguruar që personat e prekur të mos lihen keq si rezultat i projektit.

#### **4.2.3. Procedura ankimore**

Ligji mbi Shpronësimin mundëson ankesë gjatë dy fazave të procesit të shpronësimit. Gjatë fazës së parë pronarët mund të kontestojnë nevojën për shpronësimin dhe ligjshmërinë e procesit. Gjatë fazës së dytë, personat e prekur mund të sfidojnë madhësinë e pakos së kompensimit. Ligji ekzistues nuk njih asnjë proces formal të konsultimit jashtë mekanizmit të ankesave të dy fazave të përshkruar më sipër, por në praktikë këto konsultime joformale zhvillohet si një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Sipas PR5 të BERZH-it, është e nevojshme që të vendosen procedura të përballueshme dhe të arritshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të një pale të tretë që dalin nga zhvendosja; mekanizmat e tillë të ankesave duhet të marrin parasysh mundësinë e kontestit gjyqësor dhe komunitetit dhe mekanizmat tradicionale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në raste të tilla, projekti do të ofrojë një hap shtesë të përpjekjeve për të zgjidhur një mosmarrëveshje të mundshme përveç mekanizmave ekzistuese formale gjyqësore.

#### **4.2.4. Konsultimi Publik**

Legjislacioni kosovar kërkon konsultime formale publike me personat e prekur. Sipas Kornizës kosovare, konsultimi i parë përqendrohet rreth procesit të shpronësimit dhe përcaktimin e zonave me interes publik, ndërsa konsultimi i dytë ka të bëjë me kompensimin e përcaktuar nga Zyra e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme.

Sipas Kërkesave të Performancës 5 dhe 10 konsultimi është një proces i vazhdueshëm. Përveç njerëzve të prekur nga projekti, edhe komuniteti më i gjerë duhet të njoftohet në lidhje me projektin dhe ndikimet e lidhura dhe të këshillohet në tërësi dhe në mënyrë të përshtatshme. Në kuadër të marrjes së tokës dhe kontekstin e zhvendosjes, është e nevojshme që njerëzit e prekur të jenë konsultuar rreth të drejtave në lidhje me, kompensimin dhe masat zbutëse, dhe të jetë plotësisht i njoftuar në lidhje me procesin e zhvendosjes dhe blerjen e tokës, duke përfshirë edhe të drejtat e tyre dhe mekanizmat korrigjues.

#### **4.2.5. Data e skadimit të afatit**

Data e skadimit të afatit është data pas së cilës personat janë vendosur në zonën e projektit nuk kanë të drejtë në kompensim ose në përfitime të tjera të zhvendosjes sipas projektit, dhe ngjashëm me këtë edhe pasuritë e paluajtshme ose të lashtat e krijuara pas datës së skadimit të afatit nuk do të kompensohen.



Ligji i Kosovës për shpronësimin parasheh që kompensimi nuk do të paguhet për shpenzimet apo vlerën për çfarëdo përmirësimesh në pronë pas datës në të cilën vendimi për pranimin e kërkesës për shqyrtim të mëtejme të shpronësimit është botuar në Gazetën Zyrtare, ose për çdo ndryshim të vlerës së tregut për pronën, pas ose nga data e miratimit të vendimit që autorizon aktivitetet përgatitore ose datën e dorëzimit fillestar të kërkesës për shpronësim, cilado që vjen e para. Data skadimit vlen për të drejtat formale pronësore të njohura në mënyrë ligjore (kategoritë 1 dhe 2 të së drejtës).

Sipas kërkesave të politikave të BERZH-it data e përfundimit të regjistrimit dhe inventarit të pasurive përfaqëson datën e skadimit për të drejtën. Individët të cilët lëvizin në zonën e prekur të projektit pas datës së skaduar nuk kanë të drejtë për kompensim dhe llojet e tjera të ndihmës. Informacioni në lidhje me datën e skadimit do të jetë i mirë-dokumentuar dhe i shpërndarë në tërë zonën e projektit.

#### **4.2.6. Kompensimi dhe bartja e të drejtës pronësore**

Legjislacioni i Kosovës përcakton që bartja e pronësisë mund të bëhet vetëm pas përfundimit të procesit të shpronësimit dhe pagesës së kompensimit. Kompensimi duhet të përfundojë brenda dy vjetëve nga miratimi i Vendimit për shpronësim.

Në mënyrë të ngjashme, sipas kërkesave të performancës të BERZH-it, projekti mund të marrë posedimin e pronës pasi kompensimi dhe ndihmat tjera u janë dhënë personave të prekur.

#### **4.2.7. Kompensimi**

Megjithëse Legjislacioni i Kosovës siguron një metodologji të detajuar për vlerësimin e pasurive të humbura, ai nuk ofron ndonjë udhëzim të veçantë në raste të tilla kur restaurimi i jetesës është i nevojshëm. Korniza e hartuar për të adresuar shpronësimin e tokës do të përfshijë përmirësime të tokës të tilla si të lashtat dhe përgatitjet e tokës.

Në rrugën N9 në seksionin e projektit Kijevë – Zahaq pritet se do të ketë ndikim në jetesën e banorëve. Projekti do të ndikojë në jetesën nëpërmjet blerjes së tokës së kultivuar bujqësore. Në rastet kur toka e blerë është duke u kultivuar, kompensimi do të përfshijë edhe vlerën e tokës dhe kompensimin për kulturat dhe përgatitjet e tokës. Ndihma shtesë do të ofrohet sipas nevojës.

## 5. PRANUESHMËRIA DHE TË DREJTAT

### 5.1. Parimet kyçe të kompensimit, zhvendosjes dhe rikthimit të jetesës

Parimet kyçe në të cilat zotohet Ministria e Infrastrukturës përkitazi me kompensimin dhe zhvendosjen, të ndërlidhura me këtë Projekt janë:

- Janë shqyrtuar dizajne alternative të projekteve për të shmangur apo së paku minimizuar zhvendosjen fizike dhe ekonomike, gjegjësisht, përmes rirreshtimit të rrugës, ndërtimit të nënkalimeve dhe mbikalimeve për t'iu përshtatur trendeve tradicionale të lëvizjes së njerëzve në zonat mbi dhe nën rrugën e ardhshme, duke u siguruar se asnjërit prej vendbanimeve nuk i mungon qasja pas ndërtimit të rrugës, etj.
- Zbatohet studimi i hollësishëm socio-ekonomik i njerëzve/amvisërive të prekur, për të vlerësuar të gjitha ndikimet, për të ofruar informatat mbi gjendjen fillestare dhe për të dizajnuar masat e duhur të zhvendosjes/rikthimit të jetesës, të cilat do të përshkruhen në PVZH.
- Sondazhi socio-ekonomik do të shërbejë si regjistrim i personave të cilat nuk kanë të drejta të pranuar të tokës dhe as ndonjë pohim lidhur me tokën që shfrytëzojnë; data e regjistrimit do të jetë data e prerjes për pranueshmërinë lidhur me këtë kategori.
- Për të gjithë njerëzit e prekur do të organizohen konsultime dhe do të ofrohen informata gjatë zhvillimit dhe zbatimit të PVZH.
- Kompensimi për pasurinë e prekur do të ofrohet sipas çmimit të plotë të zëvendësimit.
- Për grupet e cënueshme të identifikuara me sondazhin socio-ekonomik, ofrohet ndihma specifike;
- E gjithë kompensimi dhe ndihma lidhur me rivendosjen e jetesës do të ofrohet në mënyrë të barabartë për meshkujt dhe femrat;
- Kompensimi ofrohet para marrjes në posedim të pasurisë së marrë, kudo që është e mundur, por parimisht para realizimit të zhvendosjes fizike dhe ekonomike;
- Zbatohet mekanizmi i ankimit, përmes të cilit të gjithë personat e prekur mund t'i parashtojnë ankesat e tyre lidhur me kompensimin dhe zhvendosjen dhe të presin përgjigje me kohë;
- Do të kryhet monitorimi i rregullt i të gjitha veprimeve të ndërlidhura e kompensim, zhvendosje dhe rikthim të jetesës.

### 5.2. Realizimi i regjistrimit, sondazhit të pasurisë dhe sondazhi socio-ekonomik

Sapo të ketë përfunduar Dizajni i detajshëm i Projektit, Projekti do t'i japë me kontratë palëve të treta zhvillimin e studimit, i cili do të përmbajë një listë përfundimtare të të gjitha parcelave të prekura të tokës, pasuritë e regjistruara (p.sh. Objektet) si dhe pronarët e tyre, ashtu siç janë regjistruar në kadastër. Lista do të jetë pjesë përbërëse e dokumentit të regjistrimit të popullsisë, në bazë të të cilit do të përcaktohet pranueshmëria. Gjatë procedurës së eksproprijimit, Autoriteti i Shpronësimit fton të gjithë pronarët,

shfrytëzuesit dhe të gjithë palët e treta që kanë ndonjë kërkesë lidhur me tokën e prekur apo ndonjë interes tjetër të ndërlidhur me të, ku do të zgjidhen sipas mundësisë çështjet e pranueshmërisë për kompensim. Për rastet të cilat nuk mund të zgjidhen nga Autoriteti i Shpronësimit, palët e prekur mund t'iu drejtohen gjykatave.

Regjistrimi i personave të cilët nuk kanë të drejta të pranuar ligjore apo ndonjë kërkesë mbi tokën që shfrytëzojnë në zonën e prekur nga projekti bëhet duke realizuar regjistrimin/sondazhin socio-ekonomik. Data e këtij aktiviteti do të jetë data e prerjes për pranueshmëri, do të thotë, personat të cilët kanë zënë tokën në zonën e prekur pas kësaj date, nuk do të kenë të drejtë kompensimi dhe/ose të ndihmës.

Pas realizimit të Studimit të Shpronësimit, do të kompletohet një listë e pasurive. Lista e pasurive ofron informata elementare mbi parcelën e prekur të tokës (sipërfaqja e përgjithshme e cila do të merret, destinimi, kategoria e tokës), si dhe të gjitha asetet që gjenden në të (kulturat bujqësore, pemët, pemishtet, objektet, bizneset, etj.)

Paralelisht me regjistrimin e pasurive, regjistruet të trajnuar do të kryejnë edhe sondazhin e detajshëm socio-ekonomik, ku do të përfshihen **të gjithë njerëzit / amvisëritë e prekura**. Ky sondazh do të shërbejë si një vegël për përcaktimin e gjendjes fillestare për individët / amvisëritë e prekura, i cili do të ndihmojë në përcaktimin e nivelit të ndikimit dhe për zhvillimin dhe zbatimin e mënyrave efektive dhe të përshtatshme për të zhvendosur njerëz dhe për të rivendosur apo përmirësuar jetesën e tyre.

Për secilën parcelë të prekur të tokës, gjatë sondazhit socio-ekonomik do të regjistrohen informatat vijuese:

- numri i parcelës së prekur, ashtu që të mund të ndërlidhet me raportin përkatës të vlerësimit
- emrin e pronarit/shfrytëzuesit/banorit dhe statusin e tij/saj
- detajet për kontakt për pronarin/shfrytëzuesin/banorin e prekur

Sondazhi përmban pyetje për të siguruar informata elementare mbi amvisërinë (emrat, moshat, gjinitë, shkollimin e anëtarëve të familjes si dhe vështirësitë eventuale), si dhe pyetjet lidhur me standardin aktual të jetesës dhe burimeve të të hyrave/jetesës, si dhe mundësitë për të zgjidhur kompensimin dhe ndihmën e parapëlqyer.

### 5.3. Pranueshmëria për kompensim në të holla, zhvendosje dhe ndihmë

Të gjithë individët / amvisëritë të cilët zënë tokë të prekur nga projekti, të regjistruar gjatë regjistrimit (pronarët dhe shfrytëzuesit, si formal ashtu edhe jo formal) kanë të drejtë në kompensim dhe/ose rikthim të jetesës apo ndonjë ndihmë tjetër të paraparë me Matricën e të drejtave në Seksionin 6.4 dhe Aneksin 1.

**Personat me të drejta formale ligjore dhe me të drejta të pranuar me ligje vendore:** Personat me të drejta formale ligjore regjistrohen në kadastrë dhe kjo informatë azhurnohet në përputhje me ligjet vendore, në momentin kur iniciohet procedura e shpronësimit nga Autoriteti i Shpronësimit. Personat me kërkesë të pranuar apo të pranueshme sipas ligjeve vendore gjithashtu ftohen në seancë dëgjimore, pas së cilës azhurnohen shënimet kadastrale. Në raste të kontesteve, personat e prekur mund t'iu kthehen gjykatave për zgjidhjen e tyre, të cilat duhet të procedohen para miratimit të vendimit mbi shpronësim. Shembuj të personave me kërkesë të pranuar apo të pranueshme sipas ligjeve vendore janë pasardhësit e pronarëve të vdekur, personat që kanë blerë prona me kontratë të vlefshme të shitblerjes, mirëpo nuk i kanë bartur të drejtat e tyre pronësore në emër të tyre në kadastrë dhe rastet e ngjashme.

**Personat pa të drejta formale ligjore për tokën e zënë, në momentin e regjistrimit:** Personat pa të drejta ligjore apo kërkesa lidhur me tokën që zënë (shfrytëzuesit joformal) do të regjistrohen me regjistrim, në momentin e realizimit të sondazhit socio-ekonomik. Data e përfundimit të sondazhit do të jetë data e prerjes, do të thotë që individët / amvisëritë që shfrytëzojnë/zënë tokë të prekur nga Projekti (pa të drejta apo kërkesa ligjore) pas kësaj date nuk kanë të drejtë në kompensim dhe/ose ndihmë në rivendosjen e jetesës. Shembuj të personave pa të drejta apo kërkesa ligjore janë personat që kanë ndërtuar hangarë apo ndonjë objekt tjetër në tokë publike, apo ata që punojnë tokë publike apo edhe private, pa dijen dhe/ose aprovimin e pronarit. Personat e tillë nuk do të kenë të drejtë kompensimi për tokë, pasi që nuk është në pronësi të tyre, por do të kenë të drejtë kompensimi për pasuritë që posedojnë, për shembull, vlera ndërtimore e objekteve, kulturave bujqësore, drunjve, etj.

**Grupet në nevojë nevojë:** Disa individë apo grupe do të konsiderohen si më në nevojë sesa shumica e popullsisë së prekur dhe, nëse preken nga Projekti, për ta do të nevojitet zbatimi i masave të veçanta të rikthimit të jetesës dhe/ose të ndihmës. Grupet e tilla mund të jenë:

- shfrytëzuesit joformalë të tokës së prekur, të cilët nuk kanë burime të të hyrave apo pasuri të veten;
- pronarët e objekteve joformale banesore (të ndërtuara pa leje ndërtimore), pa pronë tjetër apo vend të banimit;
- personat që varen nga toka e prekur për të hyra/jetesë dhe është e vetmja tokë që kanë në pronësi apo që shfrytëzojnë;
- amvisëri ku kreu i amvisërisë është personi i vetëm i moshuar, amvisëritë me një prind, amvisëritë me anëtarë të shumtë të cilët duhet të zhvendosen fizikisht;
- personat që do të preken nga zhvendosja fizike dhe/ose ekonomike, gjendja socio-ekonomike e të cilëve është e vështirë, për shembull, shfrytëzuesit e ndihmave sociale;
- personat që nuk dinë shkrim-lexim e të cilët mund të kenë vështirësi në vlerësimin e informata lidhur me projektin dhe marrjen e tokës, apo për të kuptuar kontratat dhe dokumentet e tjera të rëndësishme, etj.

Cenueshmëria/nevoja vlerësohet bazuar në rezultatet e sondazhit socio-ekonomike dhe definohet më për së afërmi në RAP/LRP.

**Data e prerjes:** Sipas ligjeve të Kosovës, data e prerjes përcaktohet me Vendimi e pranimit të kërkesës për eksproprijim dhe publikimit të vendimit në mediet publike, ku gazetat ditore janë një medium i tillë. Të gjitha investimet në prona pas kësaj date nuk do të merren parasysh për kompensim gjatë procesit të vlerësimit. Për personat të cilët nuk kanë të drejta apo kërkesa ligjore për tokën që zënë, data e prerjes për vlerën e pronave të prekura do të jetë data e vlerësimit të pasurisë së prekur.

## 6. SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET

Korniza finale për marrjen e tokës dhe zhvendosje (LARF) do të publikohet në ueb faqen zyrtare të agjencisë zbatuese, Ministrisë së Infrastrukturës. Gjatë procesit të hartimit të RAP, agjencia e zbatimit do të organizojë takime me pronarë të tokave dhe shfrytëzues në komunitetet e prekura lokale, për të prezantuar hartat e detajuara me parcelat e prekura të tokës dhe për të njoftuar sesi do të organizohen regjistrimi dhe sondazhi, krahas vlerësimit të pasurive të prekura. Gjithashtu do të prezantohen dhe vihen për diskutim dhe reagime parimet kryesore të kompensimit, përfshirë parashtrimin dhe zgjidhjen e kërkesave për kompensim për zhvendosje të përkohshme ekonomike dhe mekanizmi i ankesave.

Kur të jetë përgatitur RAP final, ai do të shpaloset publikisht përmes ueb faqes së Ministrisë dhe do të dorëzohet në kopje fizike në komunën e Klinës dhe Pejës si dhe në zyrat e bashkësive lokale. Privatësia e personave të prekur do të respektohet dhe asnjë informatë private nuk do të shpaloset publikisht. Ekipi i zbatimit do të organizojë intervista për regjistrim/sondazh socio-ekonomik duke kontaktuar individualisht pronarët e tokave të tilla të prekura, përmes detajeve për kontakt të dhënë në kadastër. Në rastet kur detajet e tilla mungojnë apo janë të vjetruara, projekti do të interesohet për pronarët dhe shfrytëzuesit e parcelave të tilla të tokës tek kryetarët e bashkësive lokale dhe/ose pronarët dhe shfrytëzuesit e parcelave fqinje apo të afërta të tokës dhe tek pjesëtarët e tjerë të komunitetit të cilët mund të ofrojnë informata.

Pas rezultateve të sondazhit socio-ekonomik, mund të jetë e domosdoshme të organizohen takimet individuale të fokus grupeve me grupe të veçanta të cenueshme, për të identifikuar nevojat e tyre për ndihmë dhe për të zhvilluar masa të duhura të zbutjes, të cilët do të dokumentohen në PVZH. Kur të fillojë zbatimi i RAP, projekti vazhdon të informojë dhe të konsultohet rregullisht me personat e prekur. Të gjitha takimet dhe konsultimet do të dokumentohen duke ofruar datën e mbajtjes së takimit/konsultimit, listën e pjesëmarrësve si dhe një përmbledhje të diskutimeve. Procesverbalet e këtylla përfshihen në raportet që iu dorëzohen menaxhmentit të projektit dhe BERZH-it.

## 7. MEKANIZMI I ANKESAVE

Gjatë procesit të hartimit dhe të zbatimit të RAP, të gjithë personat e prekur do të mund t'i parashtrojnë Projektit ankesat dhe sugjerimet e tyre në Ministrinë e Infrastrukturës, në zyrat e tyre, përmes postës apo telefonit.

Në Departamentin ligjor apo në ndonjë departament tjetër përkatës do të caktohen zyrtarë përgjegjës për të pranuar dhe regjistruar ankesa në një formularë të ankesave, si dhe të mbajnë protokoll të ankesave. RAP do të përfshijë emrat dhe detajet për kontakt të zyrtarëve të tillë të caktuar. Personat e prekur do të njoftohen se në ç'mënyrë mund të parashtrojnë ankesat - kur, ku dhe si. Ata do të marrin informata gjatë procesit të konsultimit të përshkruar më lartë dhe para finalizimit të RAP.

Departamenti ligjor sigurohet që ankesat t'iu cedohen dhe të marrin përgjigjen e departamenteve të Ministrisë ose kontraktuesve në afat prej 15 ditëve të punës, me shkrim. Nëse është e nevojshme, Departamenti ligjor apo ndonjë departament tjetër do t'ua shpjegojë përgjigjen me shkrim personave të prekur përmes telefonit apo personalisht. Në çdo moment ankuesit mund të kërkojnë mjete juridike të parapara me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës.

## 8. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE BUXHETI

### 8.1. Monitorimi

Sapo të jenë hartuar dhe miratuar RAP/LRP, Projekti do të monitorojë zbatimin deri sa të jenë zbutur të gjitha ndikimet e zhvendosjes, të përcaktuara me Auditimin e Përfundimit, i cili do të kryhet në bazë të marrëveshjes me BERZH-in.

Ministria themelon një sistem të brendshëm të monitorimit të Projektit, i cili përbëhet nga:

- Monitorimi i përparimit të inputeve dhe autputeve, përmes të cilëve matet nëse inputet dorëzohen me kohë dhe ashtu siç është paraparë me LARF dhe me RAP/LRP.
- Matjet periodike të treguesve të rezultateve kundrejt gjendjes fillestare, të përcaktuar me sondazhin socio-ekonomik.

Specialistë të pavarur social apo të zhvendosjes gjithashtu do të bëjnë mbikëqyrje dhe monitorim periodik të zbatimit të LARF/RAP dhe t'i raportojnë BERZH-it.

Tabela në vijim jep një listë të mundshme të treguesve, të cilët do të përdoren gjatë monitorimit. Lista përfundimtare e treguesve, e hartuar bazuar në rezultatet e sondazhit socio-ekonomik, do të përfshihet në RAP.

**Tabela 5 Tregues të mundshëm të monitorimit**

| Treguesi   | Burimi i informatave   | Intervali i matjes |
|--|--|--------------------|
| <b>Treguesit e inputeve</b>  |  |                    |
| Numri i takimeve konsultative, të fokus grupeve, rezultatet e konsultimeve   | Procesverbalet e takimeve  | Dy herë në vit     |
| Numri i personave/amvisërive të prekura, sipas kategorisë (formal ose joformal, pronarë apo shfrytëzues, grupe të cenueshme) si dhe llojet e ndikimeve (zhvendosje fizike, zhvendosje e përkohshme apo e përhershme ekonomike, të tjera) | Baza e të dhënave e zhvendosjes dhe shënimet lidhur me menaxhimin e ankesave         | Dy herë në vit     |
| Numri dhe lloji i pasurive të prekura (toka, shtëpitë, objektet jo-banesore, kulturat bujqësore, drunjë, etj.)   | Baza e të dhënave e zhvendosjes  | Dy herë në vit     |
| Shpenzimet e përgjithshme të kompensimit, zhvendosjes dhe rikthimit të jetesës   | Shënimet financiare të projektit   | Dy herë në vit     |
| Numri i punëtorëve të angazhuar për zhvendosje dhe kompensim, të zbërthyer në ata të angazhuar nga përbrenda autoritet / të angazhuar me kontratë (nëse ka të tillë)   | Departamenti ligjor i Projektit (Zyrtari për BNJ), departamentet tjera sipas nevojës | Një herë në vit    |
| Rikthimi i tokës - numri i parcelave të kompletuara  | Raportet ndërtimore të kontraktuesve dhe shënimet nga menaxhimi i ankesave           | Një herë në vit    |
| Orari i aktiviteteve të zbatuara në krahasim me orarin e zbatimit të paraparë me PVZH  | Krahasimi i statusit të zbatimit të orarit të PVZH-së                                | Dy herë në vit     |
| <b>Treguesit e outputeve</b>   |  |                    |
| Numri i kontratave të nënshkruara për kompensim, numri dhe % e pagesave të kryera për kompensim  | Baza e të dhënave e zhvendosjes si dhe shënimet financiare të Projektit              | Dy herë në vit     |
| Zhvendosja fizike - numri i njerëzve/amvisërive të zhvendosura, lloji i ndihmës së ofruar të zhvendosjes   | Baza e të dhënave e zhvendosjes  | Një herë në vit    |
| Masat për rikthim të jetesës - lloji i masave të zbatuara, progresi i zbatimit, numri i përfituesve  | Baza e të dhënave e zhvendosjes  | Një herë në vit    |
| <b>Treguesit e rezultateve</b>   |  |                    |
| Numri dhe lloji i ankesave në pritje apo të pazgjdhura si dhe trendet  | Shënimet për menaxhim të ankesave  | Dy herë në vit     |
| Koha mesatare për pagesën e kompensimit  | Koha e matur ndërmjet marrëveshjes për kompensim dhe pagesës                         | Një herë në vit    |
| A përfaqëson kompensimi koston e plotë të  | Të hetohet nëse pranuesit e  | Një herë në vit    |

| Treguesi   | Burimi i informatave  | Intervali i matjes |
|--|---|--------------------|
| zëvendësimit?  | kompensimit në të gatshme kanë mundur të blejnë pronë të ngjashme             |                    |
| Shfrytëzimi i kompensimit  | Baza e të dhënave e zhvendosjes   | Një herë në vit    |
| Zhvendosja fizike - kënaqshmëria me shtëpitë/pasuritë e reja   | Takimet individuale me njerëzit/amvisëritë<br>Baza e të dhënave e zhvendosjes | Një herë në vit    |
| Të hyrat / jetesa: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshimet në nivelin e të hyrave (i njëjtë, i rritur, i zvogëluar)</li> <li>Ri-investim në veprimtari të jetesës (blerja e tokës, pajisjeve, trajnim në shkathësi, etj.)</li> </ul> | Takimet individuale me njerëzit/amvisëritë<br>Baza e të dhënave e zhvendosjes | Një herë në vit    |

## 8.2. Raportimi

Zbatuesi i detyrës mban bazë të të dhënave lidhur me individët / amvisëritë pronat e të cilëve janë prekur nga Projekti, kompensimi, zhvendosja dhe masat e kthimit të jetesës të cilat janë zbatuar. Departamenti ligjor apo ndonjë departament tjetër i ngarkuar do të jetë përgjegjës për azhurnimin e rregullt të bazës së të dhënave. Të gjitha informatat mbi individët / familjet, pronat e tyre dhe pagesat e kompensimeve do të mbeten konfidenciale.

Duke aplikuar kornizën e monitorimit, të përshkruar në seksionin paraprak të këtij dokumenti, ekipi për zbatim të Projektit harton raportet vjetore lidhur me progresin e shënuar me zbatimin e LARF/RAP. Këto raporte konsolidojnë informatat për kompensim dhe zhvendosje/masat për rikthim të jetesës, konsultimet, informatat për negociata dhe rezultate, ofrimin e ndihmës për grupet në nevojë, menaxhimin e ankesave, etj. Ekipi për zbatim të Projektit dokumenton të gjitha takimet dhe konsultimet përmes procesverbaleve dhe fotografive, dhe i parashtron këtë BERZh-it, së bashku me raportet e progresit.

Informatat nga këto raporte do të përmbliidhen dhe të përfshihen në Raportet vjetore të mjedisit dhe menaxhimit social të Projektit, që iu shpërndahen hisedarëve relevantë, përfshirë BERZh-it.

## 8.3. Kostot e zbatimit

Kostoja për blerje të tokës dhe zhvendosje nuk mund të llogariteshin në momentin e zhvillimit të kësaj kornize, pasi që nuk ishin në dispozicion të dhënat lidhur me sipërfaqen përfundimtare të tokës së nevojshme si dhe vlerësimet e hollësishme të pronave të prekura. RAP/LRP do të përbajnë buxhet të detajuar të zhvendosjes dhe përveç kostove të kompensimit, do të përfshihen edhe shpenzimet përcjellëse, gjegjësisht kostoja e zbatimit të zhvendosjes dhe masave për rikthim të jetesës, me të cilat do



të ofrohet pagesë për bartje për amvisëritë e prekura, kostot për menaxhim dhe administrim, etj., nëse nevojiten.

Shpenzimet më të mëdha, të cilat pritet të paraqiten janë ato të ndërlidhura me kompensimin për tokën e prekur dhe kostot për ta ngritur tokën tjetër në fazë produktiviteti. Nuk pritet të preken shumë struktura të ndonjë vlere domethënëse dhe prandaj kostot e ndërlidhura me këtë, si dhe kostot e aseteve të prekura (drunjtë, bimët, rrethojat, etj.) pritet të jenë dukshëm nën koston e tokës.

### **8.1. Matrica e të drejtave**

Aneksi 1 tregon kategoritë e njerëzve / aseteve të cilat pritet të preken nga projekti, si dhe humbjet dhe ndikimit të cilat mund të paraqiten, krahas natyrës së të drejtave. Matrica përfundimtare e të drejtave e PVZH/PRJ do të përpunohet edhe më tej, për të pasqyruar të gjeturat nga sondazhi socio-ekonomik dhe të përmbajë kategori më precize, së bashku me numrat e sakta të personave/amvisërive të prekura.

**Tabela 6 Matrica e të drejtave**

| Lloji i humbjes / ndikimit  | Kategoria e PPP  | Të drejtat  |
|---|--|---|
| <i>HUMBJET E PËRHERSHME/NDIKIMET PARA NDËRTIMIT</i>   |  |   |
| Humbja e përhershme e objekteve, tokës bujqësore, pyjore dhe/ose kullosave.<br>Për shfrytëzuesit e tokës (formal dhe joformal), kjo iu referohet qasjes në tokë në pronësi private ose në tokë/resurse publike. | Pronarët e tokave                                      | Kompensimi me të gatshme me koston e plotë të zëvendësimit<br>OSE<br>Ndërtimi zëvendësues, tokë bujqësore, banesore, pyjore dhe/ose kullosat zëvendësuese   |
|   | Shfrytëzuesi formal (gjegjësisht, qiramarrësi) i tokës | Informatat lidhur me sigurimin e tokës së paku tre muaj para marrjes së tokës, për t'i mundësuar banorit të gjejë tokë tjetër për qiramarrje  |
|   | Shfrytëzuesi joformal i tokës                          | Ndihmë për të gjetur tokë zëvendësuese/resurse për shfrytëzim, para marrjes së tokës  |
| Tokë jetime (pjesë e parcelës së tokës së mbetur pas ekspropriimit, për të cilën pronari nuk ka interes ekonomik për të vazhduar shfrytëzimin)  | Pronarët e tokave                                      | Nëse është parashtruar kërkesa e pronarit të prekur të tokës dhe është shpallur si e arsyeshme bazuar në raportin e vlerësimit ekspert:<br>Kompensimi me të gatshme me koston e plotë të zëvendësimit |
| Humbja e bimëve vjetore / shumëvjeçare dhe drunjve  | Pronari i kulturave bujqësore dhe drunjve              | Kompensimi në të holla për bimët / kulturat bujqësore të humbura vjetore / shumëvjeçare me çmim të plotë të zëvendësimit  |
| Humbja e strukturave jo-banesore (rrethojat, hangarët, stallë, etj.) dhe infrastrukturës (sistemi i ujitjes)  | Pronari i objektit dhe infrastrukturës jo-banesore     | Kompensimi me të gatshme me koston e plotë të zëvendësimit<br>DHE<br>Pagesë për bartje për pasurinë e tundshme apo ndihmë në bartjen e tyre (nëse nevojitet)  |

| Lloji i humbjes / ndikimit   | Kategoria e PPP   | Të drejtat   |
|--|---|--|
| Humbja e objekteve afariste (dyqaneve, hapësirës për zyrë, punëtorive apo të ngjashme) | Pronarët e objekteve banesore                             | <p>Pagesë për bartje për pasurinë e tundshme apo ndihmë në bartjen e tyre<br/>DHE, ose</p> <p>Kompensimi me të gatshme me koston e plotë të zëvendësimit<br/>OSE</p> <p>Objekti zëvendësues afarist</p>  |
| Humbja e objekteve banesore (zhvendosje fizike)  | Pronari i shtëpisë  | <p>Ndihmë në zhvendosje, përfshirë pagesë për bartje apo ndihmë për bartje<br/>DHE, ose</p> <p>Objekti zëvendësues banesor me vlerë të njëjtë apo më të lartë (me karakteristika të njëjta apo më të mira dhe me përparësi të lokacionit)<br/>OSE</p> <p>Kompensimi me të gatshme me koston e plotë të zëvendësimit</p> <p>Nëse pronari nuk ka vend tjetër banimi dhe vlera e shtëpisë është aq e ulët sa që personi i prekur dhe amvisëria e tij/saj nuk mund të zhvendosen në banim adekuat, ashtu siç parashihet nga BERZh-i, amvisëria e prekur ka të drejtë në:<br/>Zgjedhje të opsioneve për banim adekuate me siguri të banimit (p.sh. banimi social)</p> |
|  | Shfrytëzuesi formal (gjegjësisht, qiramarrësi) i shtëpisë | <p>Informatat lidhur me sigurimin e shtëpisë së paku gjashtë muaj para rrënimit, për t'i mundësuar banorit të gjejë banim tjetër<br/>DHE</p> <p>Pagesa për bartje apo ndihmë për bartje</p>  |
|  | Shfrytëzuesi joformal i shtëpisë                          | <p>Ndihmë në zhvendosje, përfshirë pagesë për bartje apo ndihmë për bartje<br/>DHE</p> <p>Nëse shfrytëzuesi nuk ka vend tjetër të banimit:<br/>Zgjedhje të opsioneve për banim adekuate me siguri të banimit (p.sh. banimi social)</p>   |

| Lloji i humbjes / ndikimit  | Kategoria e PPP   | Të drejtat  |
|---|---|---|
| Humbja e të hyrave afariste dhe/ose burimeve të jetesës të ndërlidhura me humbjen e tokës (zhvendosje ekonomike)  | Pronari (biznesi ose veprimtaria ekonomike formale ose joformale) | Kompensim në të gatshme për të hyrat e humbura neto gjatë periudhës së tranzicionit (deri në ri-vendosjen e biznesit/veprimtarisë ekonomike në lokacionin tjetër)<br>DHE<br>Ndihmë në rivendosjen e jetesës |
| <b>HUMBJET/NDIKIMET E PËRKOHSHME GJATË NDËRTIMIT</b>  |   |   |
| Humbja e përhershme e objekteve, tokës bujqësore, pyjore dhe/ose kullosave.<br><br>Për shfrytëzuesit e tokës, kjo iu referohet qasjes në tokë në pronësi private ose në tokë/resurse publike.<br><br><i>Shënim: për humbje të kulturave bujqësore / bimëve / drunjve, shih humbjet e përhershme</i> | Pronari   | Kompensim në të holla me kosto të plotë të zëvendësimit për të drejta e shfrytëzimit të tokës me kontratë, për tërë periudhën e shfrytëzimit të tokës<br>DHE<br>Rikthimi i tokës pas përdorimit             |
|   | Shfrytëzuesi formal (gjegjësisht, qiramarrësi)                    | Informatat lidhur me sigurimin e tokës së paku tre muaj para marrjes së tokës, për t'i mundësuar banorit të gjejë tokë tjetër për qiramarrje  |
|   | Shfrytëzuesi joformal   | Ndihmë për të gjetur tokë zëvendësuese/resurse për shfrytëzim, para marrjes së tokës  |

| Lloji i humbjes / ndikimit  | Kategoria e PPP  | Të drejtat  |
|---|--|---|
| <p>Humbja e përkohshme e të hyrave afariste dhe/ose burimeve të jetesës (zhvendosje ekonomike) e ndërlidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Humbje dhe/ose qasje të vështirësuar në tokë nëpër rrugën e propozuar për qëllime bujqësore apo qëllime të tjera, për shembull, për kullosje, vjelje të kërpudhave, çajit apo bimëve të tjera, etj.</li> <li>• Ndikimet në turizëm apo në veprimtari të tjera për shkak të shqetësimeve të ndërlidhura me ndërtim (zhurma, pluhuri)</li> <li>• Dëmtim / çrregullim i përkohshëm i infrastrukturës (për shembull, në sisteme të ujitjes)</li> <li>• Aktivitetet e tjera të projektit</li> </ul> | <p>Pronari (biznesi ose veprimtaria ekonomike formale ose joformale / veprimtari e sigurimit të jetesës)</p> | <p>Kompensim në të holla për të hyrat e humbura neto (apo të hyrat e vlerësuara joformale dhe / ose humbje të jetesës) gjatë periudhës së çrregullimit.</p> <p style="text-align: center;">DHE</p> <p style="text-align: center;">Ndihmë në rivendosjen e jetesës</p> |
| <b>HUMBJET/NDIKIMET NË GRUPET E CENUESHME</b>   |  |   |
| <p>Çfarëdo ndryshimesh / ndikimesh specifike në grupet e cenueshme, të ndërlidhura me marrjen e tokës nga Projekti, të identifikuara gjatë hartimit të PVZH.</p>  | <p>Grupet / individët e cenueshëm</p>  | <p>Masat speciale për pjesëmarrje, kompensim, zhvendosje efektive dhe rikthim të jetesës, të cilat do të definojnë me PVZH/PRJ.</p>   |

## Shtojca A Matrica e analizës së hendeikut legjislativ

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja  | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës   | Mangësia / komenti  | Reagimi i propozuar  |
|------------------------------------|--|--|---|--|
| Zhvendosja e detyrueshme           | Shprehja zhvendosja e detyrueshme i referohet zhvendosjes fizike dhe asaj ekonomike. Zhvendosja mund të jetë e plotë, pjesshme, e përhershme apo e përkohshme.   | Ligji për eksproprijim rregullon çështjet e eksproprijimit të tokës dhe zhvendosjes.<br>Ligji bën dallim ndërmjet eksproprijimit të plotë, të pjesshëm, të përhershëm dhe të përkohshëm. | Ligji për eksproprijim i referohet shprehimisht zhvendosjes fizike dhe nuk njih zhvendosjen ekonomike.<br>Gjithashtu, Ligji përqendrohet në kompensim, jo në humbjen e jetesës, rivendosje apo përmirësim të saj. | Mangësitë lidhur me zhvendosjen fizike dhe ekonomike diskutohen më tej në tabelë.  |
| Marrja e tokës/kufizimet në qasje. | Zhvendosje e detyrueshme kryhet si rezultat i:<br>1. Marrjes së tokës, ku përfshihen:<br><ul style="list-style-type: none"> <li>blerjet direkte të pronës</li> <li>blerjet e të drejtave pronësore (gjegjësisht, e drejta e rrugës)</li> </ul> 2. Vendosja e kufizimeve të cilat kanë për pasojë humbjen e qasjeve në pasuri fizike apo në burime njerëzore. | Ligji për eksproprijimin rregullon eksproprijimin e tokës (si blerjet direkte të pronës ashtu edhe blerjen e të drejtave pronësore kundrejt kompensimi të përcaktuar).                   | Kufizimet të cilat rezultojnë në humbjen e qasjes në pasuri fizike apo burime njerëzore për njerëzit nuk mbulohen me Ligjin për eksproprijim.   | Duhet të shqyrtohen dhe të definohen zgjidhjet për tejkalimin e kufizimeve të cilat kanë për pasojë humbjen e qasjes në pasuri fizike apo burime natyrore (qasje në tokë, produkte pyjore, stoqe të peshqve, ujë të freskët, etj.), për secilin rast veç e veç, për secilin projekt përkatës.<br>Dokumentacioni i dizajnit të projektit dhe PVZH-të duhet të:<br><ul style="list-style-type: none"> <li>përfshijë humbjet e tilla në vlerësimin e ndikimeve tek njerëzit dhe komunitetet e prekura nga projekti, si një komponentë të humbjes së jetesës dhe të ndikimit direkt nga marrja e pronës dhe/ose zhvendosjes.</li> <li>merr parasysh humbjet e tilla gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së tokës që jepet si zëvendësim</li> </ul> Zgjidhjet mund të përfshijnë |

<sup>8</sup> Burimi i informatave: Raporti i analizës së mangësive për Kosovë, Analiza e mangësive lidhur me Kërkesat e BERZH-it për performancë 5 - 2014-Politika mjedisore dhe sociale, BERZH. Enova, konsulentë dhe inxhinierë. Faqe 15.

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja         | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës   | Mangësia / komenti  | Reagimi i propozuar   |
|---|--|--|---|---|
|   |  |  |   | (i) alternativat në naturë, të cilat mund të sigurojnë funksionet e ngjashme me pasuritë e mëhershme të pakufizuara, duke ofruar apo mundësuar qasje në resurse të ngjashme gjetiu, duke ruajtur kështu shfrytëzimin ekonomik apo funksional të pronës, ose (ii) ofrimin e kompensimit monetar për humbjen e vlerave produktive apo funksionale për shkak të humbjes së qasjes.   |
| Shtrirja e ndikimit (dizajni i projektit) | Shqyrtimi i dizajnëve të realizueshme alternative të projektit për të shmangur apo së paku minimizuar zhvendosjen fizike dhe/ose ekonomike, sociale, apo financiare kostot dhe dobitë.   | Sipas Ligjit për eksproprijim, prona private mund të eksproprijohet vetëm nëse përmbushen kushte të caktuara, përfshirë edhe kushtin që “dobitë publike që sigurohen nga eksproprijimi i tejkalojnë interesat të cilat dëmtohen në atë rast”.  | Ligji për eksproprijim nuk përmban dispozita lidhur me shmangien apo minimizimin e zhvendosjes. Mirëpo, shqyrtimi i kostove financiare shpie, në praktikë, në shmangien apo minimizimin e zhvendosjes dhe eksproprijimit.   | Të sigurohet që minimizimi i zhvendosjes fizike dhe/ose ekonomike të jetë hetuar gjatë dizajnit të projektit, deri në masën e mundshme, me synim zvogëlimin e rrezikut dhe rritjen e dobive mjedisore dhe fizike.   |
| Procesi i planifikimit                    | Realizimi i regjistrimit të popullsisë si dhe vlerësimit të gjendjes socio-ekonomike, përbrenda zonës së prekur, për të identifikuar personat të cilët do të zhvendosen dhe për të përcaktuar se kush do të ketë të drejtë në kompensim dhe ndihmë.<br>Përgatitjet për Planin e veprimit për zhvendosje apo Kornizën e rikthimit të jetesës.<br>Gjatë hartimit të PVZH/KRJ, personat e prekur (përfshirë | Sipas Ligjit për eksproprijim, procesi i eksproprijimit dhe zhvendosjes fillon pas marrjes së vendimit mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm. Para inicimit të procedurës së eksproprijimit, autoriteti i shpronësimit mund të autorizojë kryerjen e aktiviteteve përgatitore.<br>Ashtu siç parashihet me Ligj, kërkesa për eksproprijim duhet të përmbajë informata të nevojshme lidhur | Edhe pse me legjislacion vendor kërkohet mjaft mund për të mbledhur dhe prezantuar informatat mbi pronat e prekura, nuk ka kërkesa për të hartuar plane specifike të zhvendosjes / rikthimit të jetesës, apo për kryerjen e sondazheve socio-ekonomike. Gjithashtu, dokumentacioni i nevojshëm për eksproprijim nuk përmban informata mbi:<br>• Identifikimin dhe | Realizimi i regjistrimit (të plotë) / sondazhit për të përcaktuar përmasat e humbjes së jetesës dhe kush rrezikohet, si dhe hartimin e PVZH/KRJ për secilin projekt, për të cilin nevojitet marrja (zhvendosja fizike apo ekonomike).<br>Procesi duhet të sigurojë që të gjithë personat e prekur (jo vetëm ata me të drejta formale ligjore) të njoftohen dhe të konsultohen në mënyrë domethënëse. Nëse identifikohen grupet e cënueshme gjatë sondazhit, mund të nevojiten dispozita të veçanta për t'i përfshirë në procesin e konsultimit. |

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës   | Mangësia / komenti  | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|--|--|---|--|
|                                   | <p>komunitetet pritëse) duhet të njoftohen dhe të konsultohen lidhur me zhvillimin e pakove të kompensimit, kushteve të pranueshmërisë, ndihmës në zhvendosje, përshtatshmëria e lokacioneve të propozuara për zhvendosje si dhe orarit të propozuar.</p> <p>Për konsultimet me grupe të cënueshme duhet të bëhen për përgatitje të veçanta.</p> | <p>me identitetin e bartësit të së drejtës pronësore; informatat lidhur me parcelat apo patundshmërinë e prekur; lokacionin dhe numrin e secilës parcelë të prekur të patundshmërisë; përshkrimin e hollësishëm të qëllimit publik për të cilin kërkohet eksproprijimi; informata nëse, dhe në ç'masë, eksproprijimi i kërkuar përmban instalime, pjesë përcjellëse dhe/ose fruta nga prona e patundshme, etj.</p> <p>Autoriteti i shpronësimit dërgon kopjen e kërkesës dhe të gjitha dokumentet e bashkëngjitura në Zyrën për vlerësim të pronës së patundshme, dhe njofton pronarët e identifikuar të së drejtës pronësore.</p> | <p>gjendjen e grupeve të cënueshme si dhe nevojave të tyre specifike.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarëdo shfrytëzues joformal të tokës.</li> <li>• Karakteristikat socio-ekonomike të popullatës së prekur, përfshirë jetesën</li> </ul> <p>Personat e prekur njoftohen lidhur me eksproprijimin e kërkuar duke pranuar kopjen e kërkesës së parashtruar për eksproprijim (e cila gjithashtu botohet publikisht), si dhe konsultimet pasuese.</p> <p>Nuk ka dispozita të veçanta lidhur me informimin / konsultimin e grupeve të cënueshme.</p> |  |
| Ujditë e negociuara               | Ujditë e negociuara inkurajohen për të ndihmuar në shmangien e eksproprijimit dhe për të eliminuar nevojën për të përdorur pushtetin qeveritar për të larguar njerëzit me forcë.   | Ligji për eksproprijim përcakton procedurën për eksproprijim, iniciuar nga vetë autoriteti i shpronësimit apo në bazë të kërkesës për eksproprijim, të parashtruar këtij autoriteti, dhe e cila përfundon me miratimin e Vendimit përfundimtar për eksproprijim. Nuk   | Ligji për eksproprijim nuk parashihet dhe as inkurajon ujditë e negociuara.   | Ujditë e negociuara, madje edhe para fillimit të procesit të eksproprijimit (para bërjes publike të kërkesës për eksproprijim), duhet të inkurajohen shprehimisht me PVZH/KRJ. |



| Hendeku <sup>8</sup> / Çështja                              | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti   | Reagimi i propozuar   |
|---|--|---|--|---|
|   |  | ka dispozita lidhur me ujdite e negociuara.   |  |   |
| Kompensimi me kosto të zëvendësimit                         | Kompensimi për asetet e humbura ofrohet me kosto të zëvendësimit, zakonisht e llogaritur si vlera e tregut e pasurisë plus kosto të transaksionit lidhur me rikthimin e pasurisë së tillë (taksat për regjistrim dhe bartje). Amortizimi i objekteve dhe pasurisë nuk merret parasysh. | Sipas Ligjit për eksproprijim, kompensimi paguhet në bazë të çmimit të tregut të pronës, dhe përfshin çfarëdo dëme të dëshmueshme direkte, të shkaktuar për shkak të eksproprijimit plus vlerën e patundshmërisë së eksproprijuar, përfshirë çfarëdo pjesë përcjellëse apo frute.   | Ligji për eksproprijim nuk përmend në mënyrë taksative kompensimin për kostot e regjistrimit dhe taksat për bartje.  | PVZH/KRJ duhet të përshkruajë hollësisht metodën e vlerësimit dhe të parasheh që kompensimi do të ofrohet si kompensim me kosto të zëvendësimit, përfshirë edhe taksat për regjistrim dhe bartje.<br>Gjatë vlerësimeve, nuk duhet të merren parasysh amortizimi i objekteve dhe pasurisë.   |
| Kompensimi në natyrë/të gatshme                             | Kompensimi në natyrë ofrohet në vend të kompensimit me të gatshme, kudo që është e mundur.   | Ligji për eksproprijim parasheh që kompensimi paguhet me të gatshme, me një përjashtim: kompensimi në natyrë (apo kombinim i pagesës në natyrë dhe të gatshme) ofrohet ekskluzivisht në rastet kur Qeveria është autoriteti i shpronësimit, dhe eksproprijohen më shumë se 20 parcela të patundshmërisë, nëse pajtohen pronarët e pronave të tilla. | Kriteret e parapara me Ligjin për eksproprijim për kompensimin në natyrë nuk janë teknikisht të zbatueshme në praktikë, pasi që nuk ka tokë të mjaftueshme shtetërore për t'u ofruar, dhe gjithashtu për shkak se pronarë privat rrallëherë posedojnë më shumë se 20 parcela tokë. Deri më sot, nuk janë regjistruar rastet e tilla. | Planifikimi i projektit duhet të përfshijë jo vetëm aspektin e kompensimit por gjithashtu të përqendrohen edhe në zhvillim dhe rikthim të jetesës. Prandaj, PVZH-të duhet të përfshijnë opsione për kompensim të bazuar në tokë për personat e prekur të cilat varen nga toka për jetesë, duke pasur parasysh që toka zëvendësuese është e përshtatshme për prodhim të ushqimit apo për përdorime të tjera bujqësore.<br>Toka zëvendësuese nuk duhet të jetë e kufizuar vetëm në tokë në pronësi shtetërore, por mund të jetë tokë e blerë. |
| Sigurimi i banimit / strehimit adekuat me siguri të banimit | Banimit adekuat matet për nga cilësia, siguria, përbalueshmëria, banueshmëria, përshtatshmëria kulturore, qasshmëria   | Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit rregullon ofrimin e banimit të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për   | Ligji për eksproprijim nuk parasheh kompensimin në natyrë, dhe së këndejmi as sigurimin e banimit adekuat me siguri të banimit, dhe  | PVZH-të duhet të identifikojnë, bazuar në regjistrimin e realizuar, amvisëritë që kanë të drejtë në ndihmë speciale në formën e banimit / strehimit në përputhje me legjisllacionin   |

| Hendeku <sup>9</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti   | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|--|---|--|--|
|                                   | <p>si dhe karakteristikat e vendndodhjes. Duhet të ofrojë qasje në infrastrukturë dhe shërbime.</p> <p>Siguria e banimit ekziston nëse personat e zhvendosur mbrohen nga dëbimet e detyrueshme, deri në maksimumin e mundshëm.</p> <p>Lokacionet e reja të zhvendosjes, të ndërtuar për personat e zhvendosur, do të ofrojnë kushte më të mira të jetës, me siguri të banimit.</p> | <p>familjet dhe individët të cilët nuk mund të përballojnë çmimet e tregut për shtëpitë, dhe të cilët kanë nevojë për ndihmë shtetërore. Neni 4 i Ligjit përcakton kategoritë e familjeve të cilët mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, siç janë: (i) nuk posedojnë banesë apo shtëpi; (ii) janë pa shtëpi si rezultat i shkatërrimit të shtëpisë gjatë konfliktit të fundit në Kosovë; dhe (iii) posedojnë truall i cili nuk është në përputhje me standardet e banimit, të parapara për kategorinë sociale dhe ekonomike.</p> <p>Sigurimi i banimit social është përgjegjësi e komunave, ndërsa MMPH është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të duhur të këtij Ligji<sup>9</sup>.</p> <p>Ligji për eksproprijim parashih që në rast të eksproprijimit të objektit apo ndonjë pjese specifike të objektit, i cili është</p> | <p>nuk përfshin dispozitat lidhur me lokacionet e zhvendosjes.</p> <p>Mirëpo, ndihma shtetërore për amvisëritë e cenueshme sigurohet përmes Ligjit për financimin e programeve specifike të banimit.</p> | <p>vendor, dhe definojnë sigurinë e banimit si një standard elementar.</p> |

<sup>9</sup> Në periudhën nga 2010 (që nga shpallja e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit) e deri në gusht 2013, janë zbatuar gjithsej 14 projekte banimi në tetë komuna të Kosovës, ku 304 njësi të banimit social iu janë ndarë familjeve në nevojë. Në mbarë Kosovën, janë duke u zbatuar projekte të tjera, edhe pse ende ka nevoja të konsiderueshme për projekte të tjera të banimit social. Burimi: Vlerësimi i sigurimit të banimit social nga komunat e Kosovës, dhjetor 2013, OSBE, Misioni në Kosovë, <http://www.osce.org/kosovo/108196?download=true>

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja  | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës   | Mangësia / komenti  | Reagimi i propozuar   |
|--|--|--|---|---|
|  |  | ndërtuar në mënyrë ligjore dhe shfrytëzohet për banim, autoriteti i shpronësimit obligohet t'u sigurojë banorëve banim të përkohshëm, për një periudhë prej 4 muajve. Nuk ka dispozita lidhur me sigurinë e banimit.   |   |   |
| Ndhima të tjera për zhvendosje   | Kostoja e zhvendosjes (pagesa për bartje). Ndhima specifike për zhvendosje për grupet e cenueshme.   | Ndhima specifike për grupet e cenueshme sigurohet në kuadër të disa ligjeve për mirëqenien sociale, siç është Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare si dhe Ligjin për mbështetjen materiale për familjet e fëmijëve me paaftësi të përhershme, të cilat ofrojnë forma të ndryshme të shërbimeve të mirëqenies sociale apo një varg të shërbimeve të bazuara në komunitet. | Ligji për eksproprijim nuk parasheh ofrimin e kostove të bartjes dhe ndihmës specifike për zhvendosje për grupet e cenueshme.   | Kostoja e zhvendosjes duhet të kompensohet sipas kërkesave të BERZH-it, dhe të përcaktohet në të drejta të PVZH-së. Amvisëritë e cenueshme duhet të konsultohen lidhur me ndihmën që u nevojitet për zhvendosje, në bashkëpunim me departamentet për shërbime sociale. Ndhima e veçante definohet për secilin rast veç e veç, apo varësisht prej projektit. |
| Pranueshmëria për kompensim / zhvendosje dhe të drejta në rastet e zhvendosjes fizike. | Kategoria 1 - ata të cilët kanë të drejta formale mbi tokën<br>Kategoria 2 - ata të cilët nuk kanë të drejta formale mbi tokën në momentin e regjistrimit, por të cilët kanë kërkesa mbi tokë, e cila pranohet apo është e | Kategoria 1: Ligji për eksproprijim parasheh pagesën e kompensimit për ata të cilët kanë të drejta pronësore, për vlerën e pronës plus çfarëdo dëmsh direkte të shkaktuara për shkak të eksproprijimit.  | Ligji për eksproprijim përmban përkufizime më të ngushta lidhur me atë se kush ka të drejtë në kompensim/beneficion e në krahasim me kërkesa e BERZH-it. Konkretisht, dispozitat për kompensim atyre të cilët nuk kanë të | Duhet të respektohet legjislati i Kosovës dhe kërkesat e BERZH-it lidhur me pronarët dhe shfrytëzuesit joformal. Pranueshmëria e pronarëve joformal dhe masat e ndërlidhura të kompensimit duhet të shtjellohen më detajisht në PVZH-të. Në rast të zhvendosjes fizike, si minimum, duhet të sigurohet  |

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat   | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti   | Reagimi i propozuar   |
|-----------------------------------|---|---|--|---|
|                                   | <p>pranueshme sipas ligjeve vendore, duhet të pranojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kompensimin për tokën me kosto të plotë të zëvendësimit;</li> <li>- në rastin e zhvendosjes fizike, zëvendësimi i pronës me vlerë të njëjtë apo më të lartë, me karakteristika të barabarta apo më të mira dhe avantazhet e lokacionet ose kompensimit me të holla me çmim të plotë të zëvendësimit si dhe ndihma për zhvendosje.</li> </ul> <p>Kategoria 3 - ata të cilët nuk kanë të drejta të pranueshme ligjore apo kërkesa mbi tokën zënë, duhet të pranojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kompensimin për struktura të cilat i posedojnë dhe zënë dhe për çfarëdo përmirësimi në tokë me kosto të plotë të zëvendësimit.</li> <li>- në rast të zhvendosjes fizike, asortman i mundësive për banim adekuat me siguri të banimit dhe ndihmë në zhvendosje</li> </ul> | <p>Kategoria 2: Ligji bën dallim ndërmjet dy rasteve:</p> <p>(i) kompensimi në shumën e barabartë me vlerën (e dokumentuar) të ndërtimit ofrohet për humbjen e objektit nëse pronari ishte në gjendje ta legalizojë objektin, por nuk e ka bërë këtë;</p> <p>(ii) kompensimi ofrohet për pronarët e pronave në rastet kur, në datën e fillimit të ndërtimit, ishte e pamundur të sigurohej leja gjegjëse e ndërtimit nga komuna për shkak se, deri më atë datë ende nuk ishte miratuar plani urban apo hapësinor i cili mbulon pronën e tillë, me kusht që, në të gjitha aspektet tjera, as objekti dhe as ndërtimi nuk janë në kundërshtim me ligjin apo rregulloret të cilat ishin asokohe në fuqi.</p> <p>Kategoria 3: Kompensimi nuk parashihet për objektet e ndërtuara në kundërshtim me ligjin apo rregulloret, dhe nëse pronari nuk ka mundur të legalizojë objektin me ligjet e Kosovës në fuqi në datën e Vendimit përfundimtar me të</p> | <p>drejtë të pranuar ligjore apo kërkesë mbi tokën (kategoria 3) nuk është në përputhje me kërkesat e BERZH-it.</p> <p>Dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit duhet të përdoren si bazë për t'u siguruar se ata të cilët dëmtohen nga zhvendosja (zakonisht ata që i takojnë kategorisë 3) të marrin banim të duhur, ashtu siç përshkruhet më hollësisht në kategorinë "Sigurimi i banimit adekuat" më lartë.</p> | <p>ndonjë formë e banimit social, me siguri të banimit.</p> |

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat   | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti  | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|---|---|---|--|
|                                   |   | cilin autorizohet eksproprijimi.<br>Banimi adekuat rregullohet me Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit, ashtu siç është përshkruar më lartë.  |   |  |
| Data e prerjes                    | <p>Në mungesë të procedurave nga qeveria kombëtare, data e përfundimit të regjistrimit dhe inventari të aseteve përfaqëson datën e prerjes përkitazi me pranueshmërinë.</p> <p>Individët të cilët vendosen në zonën e prekur nga projekti pas datës së prerjes nuk kanë të drejtë në kompensim dhe në lloje të tjera të ndihmës.</p> <p>Informatat lidhur me datën e prerjes do të jenë të dokumentuara dhe të shpërndara mirë nëpër tërë zonën e projektit</p> | <p>Ligji për eksproprijim parasheh që kompensimi të mos paguhet për koston e vlerës së çfarëdo kompensimi pas datës në të cilën publikohet vendimi me të cilin pranohet kërkesa për procedim të mëtejshëm të eksproprijimit në Gazetën Zyrtare, apo për ndryshime në vlerën e tregut të pronës, qoftë pas datës së miratimit të vendimit me të cilin autorizohen aktivitetet përgatitore ose datës së parashtrimit fillestar të kërkesës për eksproprijim, cilado të ndodh e para.</p> <p>Data e prerjes vlen për të drejtat formale ose të pranueshme në pronë (kategoria 1 dhe 2 e pranueshmërisë).</p> | Duke qenë se me Ligjin për eksproprijim nuk njihet kategoria 3, nuk personat e tillë nuk ka ndonjë datë e tillë e prerjes.                | <p>Datat e prerjes të paraparë me ligjet e tilla vendore duhet të aplikohen (dhe të parashihen në PVZH/KRJ) në kombinim me datën e regjistrimit dhe të inventarit të pasurisë si datë e prerjes për personat pa të drejta të pranueshme për objekte (kategoria 3 e pranueshmërisë).</p> <p>Njerëzit e prekur duhet të njoftohen lidhur me datën e prerjes.</p> |
| Grupet e cenueshme                | PVZH duhet në veçanti të merr parasysh individët apo grupet të cilët mund të jenë në disavantazh apo të cenueshëm - konsultim dhe ndihmë  | Ndihmë për grupet 'në rrezik' dhe mbrojtja e tyre ofrohet, deri në masë të caktuar, në bazë të ligjeve të veçanta të cilat  | Ligji për eksproprijim nuk përmban dispozita apo masa që kanë për qëllim të mbështesin konsultim më të gjerë apo ndihmë në zhvendosje për | Grupet e cenueshme duhet të identifikohen përmes regjistrimit dhe sondazhit. Në rast se identifikohen grupet e cenueshme dhe pakicat etnike, PVZH duhet të   |

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat   | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti  | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|---|---|---|--|
|                                   | <p>në zhvendosje.</p> <p>Njerëzit e cenueshëm – njerëzit të cilët për shkak të gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, paaftësisë fizike apo mendore, disavantazhit ekonomik, apo gjendjes shoqërore mund të jenë prekur më shumë nga rivendosja sesa të tjerët dhe të cilët mund të kenë aftësi të kufizuar për të shfrytëzuar ndihmën në rivendosjes dhe beneficione të ndërlidhura zhvillimore. Për t'u mundësuar grupeve të tilla të marrin pjesë në planifikimin domethënës të zhvendosjes dhe të përfitojnë nga mundësitë zhvillimore, mund të nevojiten masat e veçanta në formë të konsultimeve dhe ndihmës në zhvillim.</p> | <p>rregullojnë të drejtat e njeriut përfshirë të drejtat pronësore: Ligji i lartcekur mbi financimin e programeve të veçanta të banimit, me të cilin ofrohen opsionet e banimit për grupet e cenueshme, si dhe Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve si dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, me të cilin definohen masat për mbrojtjen e personave të cilat i takojnë komuniteteve të pranuar në Kosovë.</p> | <p>individë apo grupe të cilët mund të jenë në disavantazh apo të cenueshëm si dhe të prekur nga ekspropriimi.</p>  | <p>definojë qartazi modalitetin dhe nivelin e nevojshëm të konsultimeve dhe ndihmës në zhvendosje për grupet e tilla.</p> <p>Autoritetet përgjegjëse për sigurimin e mirëqenies sociale duhet të konsultohen dhe të përfshihen në zbatimin e PVZH-së.</p> <p>Të gjitha komunikimet dhe dokumentacioni që iu dorëzohet pakicave etnike, si pjesë të konsultimeve, duhet të bëhen në gjuhën e duhur, të pranuar si gjuhë zyrtare apo regjionale në Kosovë.</p> |
| <p>Prona e përbashkët</p>         | <p>Të sigurohet që dokumentacioni i pronësisë apo i banimit si dhe kompensimi të lëshohen në emër të të dy bashkëshortëve apo grave kryefamiljare, varësisht prej situatës, dhe se ndihma tjetër në zhvendosje, siç janë trajnime për shkathtësi, qasja në kredi dhe në mundësi të punësimit të jenë</p>  | <p>Ligji për barazi gjinore është baza e përgjithshme ligjore për krijimin e kushteve dhe mundësive për barazi gjinore si një vlerë elementare, përmes politikave dhe programeve të cilat mbështesin zhvillimin e përgjithshëm të barabartë dhe pjesëmarrjen e meshkujve dhe</p>  | <p>Edhe pse sistemi ligjor i Kosovës dhe legjislacioni në fuqi parashih të drejta të barabarta për të dy gjinitë, nuk ka ndonjë sistem i veçantë në zbatim për të mbrojtur në tërësi nevojat e të dy gjinive në rastet e të drejtave pronësore dhe marrjes së tokës, në frymën e kërkesave të BERZH-it.</p> | <p>Përmes PVZH/KRJ, të gjitha projektet duhet të marrin parasysh nevojat specifike të të dy gjinive, në veçanti grave për dhënien e të drejtave, ndihmës në zhvendosje dhe mundësive të barabarta për t'iu qasur punësimit, resurseve, mundësive të shkollimit, dhe konsultim.</p>   |

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat   | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti   | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|---|---|--|--|
|                                   | njësoj në dispozicion për gratë dhe të jenë të përshtatura nevojave të tyre.  | grave në jetën politike, ekonomike, kulturore dhe sociale.  |  |  |
| Ndihma ligjore                    | Personave të zhvendosur duhet t'iu ofrohet ndihma ligjore për t'iu mundësuar t'i përmbushin në tërësi kushtet administrative para marrjes së tokës dhe, sipas nevojës, t'i kërkojnë të drejtat e tyre në gjykatë. | Ligji për eksproprijim nuk përmban dispozita për ndihma ligjore; mirëpo, Ligji për ndihmën juridike falas nr. 04/L-017 është baza për ofrimin e ndihmës ligjore pa pagesë në tërë territorin e Kosovës për procedura civile, administrative, të kundërvajtjeve dhe ato penale për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Agjencia Kosovare për ndihmë juridike falas është themeluar pikërisht në bazë të këtij Ligji <sup>10</sup> | Nuk ka mangësi   | PVZH/KRJ duhet të inkorporojë procedura për ofrimin e ndihmës juridike falas për personat e prekur nga projekti. |
| Orari i kompensimit               | Kompensimi (banimi alternativ dhe/ose kompensimi në të holla) duhet të ofrohet para zhvendosjes.  | Sipas Ligjit për eksproprijim, nuk mund të kryhen kurrfarë ndryshimesh në pronësi apo në të drejta të tjera të personave apo në pronën në fjalë deri në pagesën e kompensimit të paraparë me Vendimin përfundimtar.   | Nuk ka mangësi. Autoritetit i shpronësimit nuk i lejohet qasja në tokë dhe prona deri sa dhe përveç nëse pronarët e prekur pranojnë kompensimin. | PVZH duhet të përcaktojë që kompensimi pranohet para zhvendosjes së personave të prekur.                         |

<sup>10</sup> Përveç themelimit të Agjencisë për ndihmë juridike falas me seli në Prishtinë dhe 13 zyre rajonale në tërë Kosovën, në Kosovë janë zhvilluar edhe projekte të fokusuar në ndihmë juridike falas për çështje minoritare (dokumentet personale, të drejtat pronësore, etj.) të cilat ishin udhëhequr nga CRPK (financuar nga UNHCR), Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim rajonal - CLARD (e financuar nga BE), Lëvizja për paqe - MPDL, etj.

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja   | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës             | Mangësia / komenti   | Reagimi i propozuar  |
|---|--|--|--|--|
| Humbja e stabilimenteve publike   | Në rastet kur, për shkak të projektit, humben stabilimentet publike, klienti ndërmerr konsultime domethënëse me komunitetin e prekur lokal për të identifikuar dhe për t'u dakorduar për alternativat e përshtatshme të tyre, kudo që është e mundur.  | Nuk ka dispozita në legjislacionin vendor. | Nuk ka kërkesa të veçanta për t'u konsultuar me komunitetet e prekura lidhur me humbjen e stabilimenteve publike, jashtë kërkesës për konsultim të përgjithshëm publik si pjesë e procesit të konsultimit. | Humbja e stabilimenteve publike duhet të identifikohet gjatë fazës së përcaktimit të shtrirjes (scoping) të projektit, si dhe të trajtohet me PVZH.  |
| Pranueshmëria për kompensim / rikthim të jetesës dhe të drejta në rastet e zhvendosjes ekonomike. | Nëse marrja e tokës shkakton humbje të të hyrave apo të jetesës. Kategoria 1 dhe Kategoria 2 duhet të pranojnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Kompensim për pasurinë e humbur apo qasjes në pasuri, me kosto të plotë të zëvendësimit.</li> <li>Pronë zëvendësuese me vlerë të njëjtë apo më të madhe, apo kompensim me të gatshme me kosto të plotë të zëvendësimit.</li> </ul> Kategoria 3 duhet të pranojë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Humbjen e asetëve, përveç tokës, me kosto të plotë të zëvendësimit</li> </ul> Të tre kategoritë duhet të pranojnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Kompensimin për koston e rivendosjes së veprimtarive</li> </ul> | Nuk ka dispozita në legjislacionin vendor. | Ligji për eksproprijim nuk rregullon humbjen e të hyrave apo jetesës në rast të zhvendosjes ekonomike.   | Të drejtat për të tre kategoritë duhet të specifikohen në PVZH/KRJ në përputhje me kërkesat e BERZH-it dhe bazuar në të gjetura nga regjistrimi dhe nga sondazhi socio-ekonomik. <p>Humbja e pasurisë apo qasjes në pasuri që shpie në humbje të burimeve apo mjeteve të jetesës (përfshirë kufizimin e qasjes në burime natyrore) duhet të kompensohet, varësisht prej llojit të humbjes, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndihmës për të rikthyer jetesën e bazuar në tokë (ofrimin e tokës zëvendësuese për kategoritë 1 dhe 2; sigurimin e qasjes në tokë dhe kompensimin për pasuritë e humbura, përveç për tokë, për kategorinë 3; ofrimin e kompensimit për përgatitjen e tokës bujqësore apo inputeve bujqësore për të gjitha kategoritë)</li> <li>Ndihmë bizneseve (formale dhe joformale) (ofrimi i zëvendësimit për kategoritë 1 dhe 2; ofrimi i qasjes në hapësirë të</li> </ul> |



| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat  | Dispozitat e ligjit të Kosovës | Mangësia / komenti | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|--|--------------------------------|--------------------|--|
|                                   | <p>komerciale gjetiu</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompensimin për të hyrat neto të humbura gjatë periudhës së tranzicionit</li> <li>• Kompensimin për koston e transferit dhe ri-instalimit të impianteve, makinerive apo pajisjeve të tjera.</li> <li>• Mbështetje kalimtare bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të kohës së nevojshme për të ri-vendosur kapacitetet për fitim të të hyrave, nivelet e prodhimit, apo standardin e jetesës.</li> <li>• Ndihma shtesë e shënjestruar (lehtësira kreditore, trajnim, apo mundësi punësimi) dhe mundësi për personat e prekur, jetesa apo të hyrat e të cilave janë prekur në mënyrë negative (këtu pronarët e bizneseve dhe punëtorët e prekur kanë të drejtë).</li> </ul> |                                |                    | <p>duhur komerciale me siguri të banimit për kategorinë 3; kompensim për të hyrat e humbura dhe për koston e ri-vendosjes së biznesit, si dhe mbështetje shtesë siç është trajnimi për të gjitha kategoritë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndihmë në ri-vendosjen e jetesës bazuar në moshë (ofrimin e trajnimeve të shkathtësisë, e cila mund të bëhet në kuadër të projekteve ekzistuese në Kosovë<sup>16</sup> apo në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të Kosovës<sup>11</sup>: duke ofruar kështu kompensim për humbjen e të hyrave)</li> </ul> <p>Të gjitha kategoritë duhet të kompensohen pa vonesë para humbjes së qasjes/pronave në mënyrë që të minimizohet apo shmangët humbja e të hyrave neto dhe nevoja për mbështetje kalimtare.</p> <p>Kostoja e zhvendosjes duhet të kompensohet me të holla apo transport të pajisjeve dhe me asete të tjera, organizuar nga autoriteti i shpronësimit.</p> |

<sup>11</sup> Agjencia e Punësimit e Kosovës do të jetë funksionale që nga janari 2015 dhe do të ofrojë shërbime në tregun e punës dhe do të punojë në zbatimin e politikave të punësimit dhe trajnimeve profesionale

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja             | Kërkesat e BERZH-it për politikat   | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti  | Reagimi i propozuar   |
|---|---|---|---|---|
| Procedura e ankesës                           | <p>Mekanizmi ankimor do të themelohet sa më herët të jetë e mundur në proces, për të pranuar dhe shtjelluar me kohë brenga specifike lidhur me kompensimin dhe zhvendosjen, të cilat pranohen nga personat e zhvendosur dhe/ose pjesëtarët e komunitetit pranues, përfshirë edhe mekanizëm të ankimit të krijuar me synim zgjidhjen e kontesteve në mënyrë të paanshme.</p> <p>Mekanizmi, procesi apo procedura e ankesës duhet të shtjellojnë pa vonesë dhe në mënyrë efektive brenga, duke aplikuar një proces të kuptueshëm dhe transparent, të përshtatshëm nga aspekti kulturor dhe i qashtë për të gjitha segmentet për komunitetet e prekura, pa kosto dhe pa ndëshkime.</p> | <p>Sipas Ligjit për eksproprijim, pronarët apo bartësit e interesave kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa në faza të ndryshme të procesit (ankesa për kompensim për punët përgatitore ankesat kundër vendimeve preliminare dhe përfundimtare për eksproprijim; ankesat kundër vendimeve përfundimtare).</p> <p>Gjithashtu, palët e interesuar kanë të drejtë të parashtrojnë komentet me shkrim autoritetit i shpronësimit gjatë procesit të konsultimeve.</p> | <p>Edhe pse Ligji për eksproprijim parasheh që personat e prekur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë para gjykatave kompetente gjatë fazës së planifikimit të procesit të eksproprijimit (dhe, në praktikë, autoritetet përgjegjëse përpiqen të arrijnë marrëveshje miqësore me pronarët apo bartësit e interesave në mënyrë që të shmangen vonesat në eksproprijim), nuk ka dispozita lidhur me mekanizma të ankesës specifike për projektin, i cili do të mundësonte zgjidhjen e kontesteve para kërkimit të rrugës ligjore në gjykata.</p> | <p>Të gjitha projektet do të themelojnë mekanizma të ankesës si pjesë e PVZH/KRJ-ve të tyre.</p> <p>Deri në masën e mundur, projektet duhet t'i ngrisin kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për eksproprijim lidhur me modalitetet dhe dobitë e krijimit të një mekanizmi të ankesave, si mjet për të shtjelluar brengat e personave të prekur nga projekti sa më herët në proces, dhe kështu t'i zvogëlojnë rreziqet e shmangies së eksproprijimit.</p> |
| Shpalosja e informatave dhe konsultimi publik | <p>Klienti duhet të përmbledh informatat e parapara me PVZH dhe/ose KRJ për shpalosje publike për t'u siguruar që personat e prekur t'i kuptojnë procedurat e kompensimit dhe dinë se çfarë të preson në fazat e ndryshme të projektit (p.sh., kur t'iu</p>   | <p>Ligji për eksproprijim i cakton autoritetit i shpronësimit detyra vijuese lidhur me shpalosjen e informatave dhe konsultimeve publike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të njoftojë bartësit e identifikuar të të drejtave</li> </ul>  | <p>Ligji për eksproprijim nuk i merr parasysh nevojat e pakicave etnike dhe personave të zhvendosur intern (PZH) si dhe personat e prekur të cilët nuk janë të përfshirë në konsultime për të siguruar informim adekuat dhe me kohë. Për më tepër, Ligji për</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Përveç kërkesave për shpalosje të informatave dhe konsultimeve të parapara me legjislacionin vendor, PVZH-të/KRJ duhet të përfshijnë konsiderata të veçanta lidhur me nevojat e pakicave etnike dhe të zhvendosurve intern, si dhe personave të prekur të cilat nuk</li> </ul>   |

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat   | Dispozitat e ligjit të Kosovës  | Mangësia / komenti   | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|---|---|--|--|
|                                   | <p>bëhet një ofertë, sa kohë nevojitet për t'u përgjigjur, procedurat e ankesës, procedurat ligjore që duhet të ndiqen nëse dështojnë negociatat). Konsultimet vazhdojnë gjatë zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të pagesave të kompensimit dhe zhvendosjes.</p> | <p>pronësore lidhur me kërkesën e parashtruar për eksproprijim;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të publikojë vendimin për aprovimin e kërkesës në Gazetën zyrtare, dhe në gazetën ditore, si dhe t'i ripublikojë sërish pas 7-10 ditëve;</li> <li>• të pranojë komente me shkrim nga palët e interesuar gjatë periudhës 10 ditore pas publikimit;</li> <li>• të mbajë dëgjim publik brenda 15 ditëve në çdo komunë ku gjenden pronat;</li> <li>• të shqyrtojë komentet me shkrim dhe brengat e shprehura në dëgjime, si dhe të miratojë Vendim preliminar në afat prej 30 ditëve - përfshirë edhe njoftimin me të cilën njoftohen pronarët e prekur / bartësit e interesave lidhur me të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë tek</li> </ul> | <p>eksproprijim nuk rregullon procedurën për t'u marrë me pronarët e pronave që nuk janë të pranishëm, dhe nuk përmban masa për t'u siguruar se të drejtat e pronave të tillë për t'u njoftuar në mënyrë adekuate dhe me kohë lidhur me çfarëdo masa administrative të cilat ndërmerren ndaj pronave të tyre dhe për mjete efektive ligjore.</p> | <p>përfshihen në konsultime në mënyra të tjera (si për shembull, pronarët/shfrytëzuesit joformal) për të siguruar informim adekuat dhe me kohë përmes PVZH-ve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shfrytëzimit adekuat të gjuhë zyrtare gjatë shpalesjes së informatave relevante, si dhe përpjekjeve për të arritur tek bartësit e të drejtave, p.sh. të zhvendosurit intern.</li> <li>• Lidhur me pronarët e pronave në mungesë, agjencia e Kosovës për zbatim të projektit duhet qartazi të zotohet në PVZH/KRJ që të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të:</li> <li>• identifikuar dhe gjetur në mënyrë të duhur të gjithë pronarët e pronave që mungojnë</li> <li>• të angazhojë për ndihmë zyrat e komuniteteve pakicë dhe/ose organizatat joqeveritare në Kosovë të cilat merren me refugjatë, pakica dhe të kthyerit për të gjeturit pronarët që mungojnë (siç është Programi i të drejtave qytetare në Kosovë, Organizata ndërkombëtare për migrim dhe OJQ-të e ngjashme)</li> <li>• të deponojë shumën e kompensimit në një llogari të veçantë në Bankën Qendrore të Kosovës</li> </ul> |

| Hendeku <sup>8</sup> /<br>Çështja | Kërkesat e BERZH-it për politikat                  | Dispozitat e ligjit të Kosovës   | Mangësia / komenti   | Reagimi i propozuar  |
|-----------------------------------|--|--|--|--|
|                                   |  | <p>gjykata kompetente për të sfiduar vendimin;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të ndërmer veprime për të njoftuar personat e identifikuar në kërkesë, dhe të shpall Vendimet preliminare në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetë ditore.</li> <li>të publikojë Vendimet përfundimtare me të cilat aprohet apo refuzohet kërkesa në afat prej 10 ditëve pas marrjes në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë ditore.</li> </ul> |  |  |
| Monitorimi                        | Monitorimi i RAP/LRP-së bëhet në përputhje me PR 1 | Nuk ka dispozita   | Nuk ka kërkesa lidhur me monitorimin e procesit të eksproprijimit / zhvendosjes / rikthimit të jetesës në kuadër të legjislacionit të Kosovës. | Të gjitha projektet që merren me zhvendosje, marrje të tokës dhe zhvendosje ekonomike duhet të kenë një mekanizëm monitorimi, të definuar edhe me RAP/LRP. |